



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE
Seria e Analizave Politike 2012 / 05

**AUTONOMIA PËR PJESËN VERIORE
TË KOSOVËS:
*SHPALOSJA E SKENARËVE DHE
PASOJAT PËR RAJONIN***

Prishtinë, korrik 2012

Përgatitur nga: Shpend Kursani dhe Ilir Deda

E drejta autoriale © 2012 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni info@kipred.org apo +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778
www.kipred.org

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Kosova.....	6
2.1. Funksionimi i shtetit	6
2.2. E ardhmja e serbëve të Kosovës	8
2.3. Shqiptarët e pakënaqur të Kosovës	8
3. Serbia Jugore (Lugina e Preshevës)	9
3.1. Lidhja me Kosovën: momentet kryesore.....	9
3.2. Kushtet aktuale sociale të shqiptarëve.....	11
3.3. Dinamikat e politikës lokale në Luginë pasqyrojnë Kosovën.....	12
3.4. Autonomia e Veriut të Kosovës dhe Lugina: Shpalosja e Skenarëve	13
4. Maqedonia	15
4.2. Ndikimi i Marrëveshjes së Ohrit në pozitën e shqiptarëve	18
4.3. Pakënaqësitë dhe politika	19
4.4. Autonomia e Kosovës Veriore dhe Maqedonia: Shpalosja e skenarëve	21
5. Akterët e mbetur rajonal dhe të tjerë ndërkombëtarë	22
5.1. Akterët rajonal.....	22
5.2. Akterët ndërkombëtarë.....	23
6. Skenari përfundimtar	24

1. Hyrje

Në shkurt të vitit 2012 KIPRED ka publikuar analizën “*Vizioni gjithëpërfshirës për Veriun: Mundësia e Fundit*”¹, duke përcaktuar një strategji që përmbante hapa të detajuar që duhej të merreshin asokohe nga akterët e shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë për ta integruar veriun – në mënyrë paqësore. Analiza bënte thirrje dhe përcaktonte veprimet urgjente për parandalimin e konfliktit ndëretnik në Kosovë, shmangien e krijimit të shtetit jofunksional dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal. Supozimi themelor i punës ka qenë se të gjithë hisedarët do të ishin serioz në përmbushjen e mandateve të tyre dhe të marrin hapa vendimtarë për zbatimin e Planit të Ahtisaarit edhe në veri. Ka qenë momenti i fundit për ta bërë këtë, duke marrë parasysh faktin se analiza u publikua një muaj para vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian (BE) për ti dhënë Serbisë statusin e vendit kandidat të BE-së dhe më shumë se tre muaj para mbajtjes së zgjedhjeve² në Serbi; të cilat janë konsideruar si momente kyçe të kthesës që hisedarët ndërkombëtarë³ dhe Qeveria e Kosovës (QeK) do ti mund t’i përdornin për ta shtyrë Serbinë për përmbushjen e tri kushteve⁴ të Kancelarës gjermane, Angela Merkel, e të cilat do të rezultonin me ndryshime kuptimplota në pjesën veriore të Kosovës.⁵

Me paralajmërimin për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur në mes të shtatorit të 2012-ës, çështja e veriut të Kosovës pritet të “zgjidhet” me një dialog politik gjithëpërfshirës ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, i cili mund të nis në vjeshtë. Duke e marrë parasysh dështimin në zbatimin e Planit të Ahtisaarit në veri, njëfarë forme e “Ahtisaari Plus-it” si zgjidhje për këtë hapësirë shihet si e vetmja mënyrë e ecjes përpara nga vendet kryesore perëndimore.

Ka disa variante se çfarë do të thoshte “Plusi” – nga dispozita të shërbimeve të përbashkëta ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, që është një ri-interpretim liberal i Planit të Ahtisaarit deri te autonomia territoriale e pjesës veriore – që do të kufizonte deri në një masë të caktuar autoritetin e Prishtinës në atë pjesë të territorit.

Derisa BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara (SHBA) janë duke kërkuar konsensus për shtyrjen tutje të çështjes së veriut, statusi i veriut i palidhur me statusin e serbëve të Kosovës në jug të lumit Ibër nuk po ka mbështetje në jug. Ka një kundërshti shumë-etnike për zgjidhjen mono-etnike për veriun nga të gjitha partitë shqiptare të Kosovës, të gjithë akterët serbë të Kosovës në jug të Ibrit, duke përfshirë edhe Kishën Ortodokse Serbe dhe organizatat kryesore të shoqërisë civile.

Në pjesën veriore të Kosovës nuk ka pasur shumë ndryshime. Derisa barrikatadat kryesore rrugore në veri janë shpërbërë nga KFOR-i – në përjashtim të asaj kryesores që ndan

¹ “*Vizioni gjithëpërfshirës për Veriun: Mundësia e Fundit*”, KIPRED, Analizë, 2012/2,

http://www.kipred.org/advCms/documents/26694_A_Comprehensive_Vision_for_the_North_the_final_countdown.pdf.

² Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë mbajtur në Serbi, përfshirë dhe Kosovën, më 6 maj 2012 me pajtimin e Qeverisë së Kosovës, Qeverisë së Serbisë dhe hisedarëve kryesorë ndërkombëtarë. Zgjedhjet serbe në Kosovë janë administruar dhe monitoruar nga OSBE-ja. Zgjedhjet lokale, nuk janë mbajtur në Kosovë, pos në komunat e Zveçanit dhe Zubin Potokut, të cilat ishin ilegale sipas autoriteteve të Serbisë dhe të Kosovës, por edhe hisedarëve ndërkombëtarë.

³ Kryesisht, Kuinti dhe Zyra e BE-së në Kosovë.

⁴ Tre kushtet kanë qenë: (1) Shpërbërja e strukturave paralele të sigurisë; (2) lejimi i veprimit të plotë të EULEX-it; dhe (3) zbatimi i marrëveshjeve/konkluzioneve të arritura në dialogun Beograd-Prishtinë të ndërmjetësuar nga BE-ja që nga atëherë.

⁵ Ambasadori britanik në Kosovë, Ian Cliff dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Sllovakisë kohë më parë i janë bashkuar njërit prej kushteve të Merkelit për Serbinë që të shpërbëj strukturat paralele të sigurisë në veri.

qytetin në urën kryesore,⁶ strukturat paralele mbeten të gatshme për të vendosur ato në secilin moment të duhur, siç është parë më 3 korrik 2012. Ekzistojnë pikat e sakta përgjatë rrugëve kryesore prej Zveçanit deri në portën 1 (Jarinje) dhe në rrugët alternative drejt Serbisë në të cilat “njësitë komunale të mbrojtjes territoriale” kanë grumbulluar drunj, rimorkio të kamionëve, zhavorr skaj arterieve kryesore (urat dhe kthesat kryesore), të gatshme për t’u instaluar brenda një kohe të shkurtër (15 deri 30 minuta).⁷ KIPRED ka vërejtur së paku 30 lokacione të tilla vetëm në komunën e Leposaviçit.

Strukturat paralele të sigurisë nuk janë shpërbërë; EULEX-i ende nuk është në gjendje që të dërgoj më shumë se dhjetëra pjesëtarë në veri dhe në shumë raste është e kufizuar që ta bëjë këtë nga zyrtarët serbë në veri, të cilët u japin leje të rastit⁸ të parëve për të lëvizur në këtë pjesë të Kosovës;⁹ një bombë ka shpërthyer në një banesë të vendosur në një hapësirë multietnike në Mitrovicën e veriut, duke mbytur një dhe plagosur dy banorë të përkatësisë etnike shqiptare dhe duke zhvendosur më shumë se 40 familje shqiptare nga pjesa veriore; mallrat¹⁰ vazhdojnë që të kontrabandohen nëpërmjet rrugëve alternative,¹¹ dhe prania ndërkombëtare dhe vendore në portat 1 dhe 31 luajnë pak rol në ndalimin e tyre.

Mbi të gjitha, statusi i vendit kandidat të BE-së për Serbinë nuk ka rezultuar në përputhje me shpresat e perëndimit rreth rezultateve të zgjedhjeve presidenciale të Serbisë, në të cilat fitoi Tomislav Nikoliç, lideri i Partisë Përparimtare Serbe (SNS), një fraksion i dalë nga Partia Radikale Serbe (SRS) e të akuzuarit të TPNJ-së, Vojislav Sheshel.

Deri në disfatën elektorale të ish-presidentit Boris Tadiq dhe të Partisë Demokratike (DS), pozicioni i Serbisë ka qenë plani katër-pikësh i Tadiqit, duke propozuar autonomi të plotë territoriale për veriun me krijimin e “Rajonit të Veriut të Kosovës”. Plani katër-pikësh është mbështetur nga një numër diplomatësh perëndimorë,¹² të cilët kanë pritur “një ofertë” nga kryeministri Hashim Thaçi si përgjigje.¹³ Pozicioni i Serbisë në lidhje me veriun me gjasë do të ngurtësohet, duke pasur parasysh riorganizimin politik që kanë sjellë zgjedhjet e 6 dhe 20 majit në Serbi. Me Nikoliçin si president dhe pasardhësin e Milosheviqit, Ivica Daçiq, me gjasë si Kryeministër, Serbia do të përpiqet që të propozoj ndarjen për njohjen e Kosovës, ose një veri me pavarësi të lartë brenda Kosovës, varësisht nga qëndrimi i hisedarëve ndërkombëtarë. Vija e kuqe e Beogradit në negociatat e ardhshme për çështjen e veriut do të jetë plani katër-pikësh i Tadiqit me gjasë të pamundshme për kompromisin në njohjen de-facto të Kosovës, për të cilën gjë bashkësia ndërkombëtare do të bëjë presion.

⁶ KFOR-i ka larguar një barrikadë në Rudare, Zveçan, më 1 qershor 2012, që është shoqëruar me dhunë, ku 5 njerëz janë lënduar (2 ushtarë të KFOR-it gjerman dhe 3 pjesëtarë të komunitetit serb), dhe më shumë se 30 plumba janë shtënë në drejtim të trupave të KFOR-it dhe veturave të tyre.

⁷ Vrojtim nga hulumtuesi i lartë i KIPRED-it në veri, 9 qershor 2012, Mitrovicë, Zveçan, Leposaviq, Jarinje.

⁸ Shih: B92, “Roads in northern Kosovo open for traffic”, 8 maj, 2012, http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2012&mm=03&dd=08&nav_id=79164.

⁹ EULEX-it i jepen ndonjëherë 3 raunde të patrullimit në ditë, nganjëherë 2 raunde, dhe kjo varet nga vendimi i strukturave serbe në veri që vendosin.

¹⁰ Kryesisht naftë, cigare dhe ushqim.

¹¹ Kajtazi, V. “Rrugët e kontrabandës në veri”. Koha Ditore. 14 maj 2012,

<http://www.koha.net/index.php?page=1.13.99309>

¹² Shih deklaratën e ambasadorit britanik në Kosovë, Ian Cliff: B92, “Tadic’s suggestion in line with Ahtisaari plan”, 17 janar, 2012, http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2012&mm=01&dd=17&nav_id=78329

¹³ Palokaj, A. “Ndërkombëtarët duan konsensus të brendshëm për veriun”, Koha Ditore 30 janar, 2012, <http://www.koha.net/?page=1.13.85934>

Në anën tjetër, Prishtina vazhdon që të përsëris qëndrimin zyrtar se ekziston “Plani i Ahtisaarit”¹⁴ si plan për veriun. Më 23 maj 2012, Qeveria e Kosovës (QeK) vendosi që të themeloj Zyrën Administrative në Mitrovicën e veriut e që parashihet të operacionalizohet në tërësi më 22 korrik 2012. QeK së bashku me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe Kuintin vazhdojnë të besojnë se kjo zyre, që de-facto shërben si komunë, do të integroj atë pjesë të territorit. Duke marrë parasysh se 250 serbë të Kosovës kanë aplikuar për 55 pozita të lira kah fundi i qershorit, QeK dhe prania ndërkombëtare besojnë se kjo nënkupton një shkallë të lartë të gatishmërisë së serbëve të veriut të Mitrovicës për t’u integruar brenda Kosovës. Këto hapa të vetëm nuk do ta ndihmojnë QeK-un që e vetmuar të integroj veriun, dhe po shtrohet terreni për “integrimin” përmes kompromisit që do të arrihej nëpërmjet një procesi politik me Serbinë. Qeveria aktuale nuk ka fuqi të mjaftueshme politike dhe nuk duket se do të negocionte e vetmuar me Serbinë për veriun. Kjo është arsyeja se pse disa diplomat perëndimorë po përpiqen që të lidhin dy partitë kryesore të dala nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) – Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) të kryeministrit Hashim Thaçi dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të Ramush Haradinajt – drejt koalicionit të ri qeverisës. Kjo “Qeveri e UÇK-së”, sipas tyre, do ta kishte më të lehtë arritjen e kompromisit për çështjen e veriut në procesin politik me Beogradin.

Duke marrë për bazë shkallën e mbështetjes në BE dhe SHBA për një proces të ri politik ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në të cilin do të zgjidhej çështja e veriut, është shumë e mundshme që zgjidhja për veriun të arrihet rreth një shkalle të caktuar të autonomisë brenda varianteve të “Plus-it” të Planit të Ahtisaarit të shpjeguar më lartë. Prandaj, kjo analizë, nënvizon skenarët e mundshëm që do të hapen në Kosovë, Lugjinë e Preshevës, Maqedoni dhe në tërë Ballkanin Perëndimor në rast të materializimit të një zgjidhjeje të tillë për veriun.

2. Kosova

Autonomia për veriun e Kosovës (Ahtisaari Plus)¹⁵ do të ketë ndikim mbi i) funksionalitetin dhe stabilitetin e Kosovës; ii) do të ketë ndikim negativ mbi serbët e Kosovës; dhe iii) do të ndez frustrimet dhe rris pakënaqësinë në mesin e shqiptarëve të Kosovës, të cilët do të jenë të vendosur për ndryshimin e realitetit të ri të imponuar.

2.1. Funksionimi i shtetit

Parametrat minimalë për funksionimin e duhur të shtetit të Kosovës janë siguruar nga dispozitat e përshkruara në Planin e Ahtisaarit. Është ofruar autonomi e gjerë komunale dhe vetëqeverisje për serbët e Kosovës ku qeveritë lokale kanë autoritet, në mes tjerash, që të: (1) emërojnë shefat lokal të policisë; (2) menaxhojnë në tërësi edukimin parashkollor, primar dhe sekondar duke përfshirë menaxhimin komunal të Universitetit autonom të Mitrovicës së Veriut, me kurikula (plan-programe) të zhvilluara nga Serbia; (3) përfaqësim dhe ulëse të rezervuara në gjyqësinë lokale; (4) ofrojnë shërbime publike lokale (duke përfshirë planifikimin urban dhe zhvillimin, financat lokale dhe mbledhjen e taksave, menaxhimin e tokës, ndërtimin, regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, etj.); (5) menaxhojnë zhvillimin ekonomik lokal; (6) ofrojnë shërbimin shëndetësor primar dhe sekondar, duke përfshirë dhe vetë-menaxhimin e tri spitaleve publike (në Mitrovicën Veriore, Graçanicë dhe Shtërpce); (7) përdorin gjuhën e tyre dhe alfabetin cirilik; (8) menaxhojnë aktivitetet kulturore si dhe të përfitojnë nga ruajtja fetare dhe e identitetit; (9) të kenë dhe të menaxhojnë mediet e tyre; (10) bashkëpunojnë me Serbinë në të gjitha

¹⁴ Vazhdimisht është vënë në dukje nga ana e Kryeministrit të Kosovës, Ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës, Zëvendësministri i Jashtëm i Kosovës, dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë.

¹⁵ Autonomia për veriun dhe Ahtisaari Plus janë përdorur në mënyrë të këmbyeshme në këtë dokument.

fushat e kompetencës, duke përfshirë të drejtën për të pranuar fonde pa taksa nga Serbia dhe kapital njerëzor; dhe bashkëpunim ndër-kufitar me komunat në Serbi.

Gjerësia e një autonomie të tillë e cila tashmë iu jep komunave me shumicë serbe në Kosovë një status special, duke përfshirë një bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Serbinë (ose lidhje speciale me Serbinë), në të vërtetë, do të duhej t'i jepte Serbisë të drejtën që në mënyrë direkte t'i ndajë përgjegjësitë për mirëqenien dhe zhvillimin e serbëve të Kosovës në partneritet dhe transparencë me Kosovën. Kjo marrëveshje speciale për serbët e Kosovës bën që shteti tashmë të qëndroj në kufirin e një funksionimi të rregullt. Duke shtuar një shtresë shtesë të çfarëdo niveli të autonomisë territoriale¹⁶ në majë të autonomisë speciale që tashmë është ofruar për serbët do të çojë kah të bërit Kosovën një shtet të dështuar, të paaftë të menaxhojë çështjet ekonomike, popullatën, territorin, dhe aq më pak marrëdhëniet ndër-etnike siç janë paraparë me Kushtetutë.

Veç ndikimit që një autonomi e tillë do të ketë në (mos)funksionimin e përgjithshëm të shtetit, ajo gjithashtu do të bëjë që shteti, i cili në periudhën afatmesme do t'i nënshtrohet procesit të anëtarësimit në BE,¹⁷ ta ketë të pamundur ta bëjë këtë. Autonomia për një pjesë të territorit dhe për një grup të një komuniteti brenda shtetit krijon një sistem të decentralizuar disa-shtresor të vendim-marrjes që do të bëjë të pamundur funksionimin e rregullt të Kosovës. Kjo autonomi, për më shumë, do të sigurojë mjaft kompetenca sektorëve të ndryshëm kryesorë në atë zonë aq sa për të zvarritur proceset kyçe për funksionimin e shtetit dhe të cilat i kërkon me ngulm BE-ja. Siç tregon funksionimi i Bosnje-Hercegovinës (BeH), liderët veriorë në de facto entitetin e tyre mund të vendosin të mos bashkëpunojnë me autoritetin qendror për siguri, menaxhimin e kufijve, inteligjencë, çështje fiskale, gjyqësor, dhe të gjitha fushat që kjo autonomi mund t'i rrethoj. Këto fusha nuk janë të rëndësishme vetëm për funksionimin e shtetit, por gjithashtu për përmbushjen e kushteve gjatë aplikimit për statusin e vendit kandidat të BE-së ose çfarëdo faze të mëhershme në procesin e anëtarësimit. BeH është një shembull i plotë i asaj se çfarë i ndodh një shteti të Ballkanit me autonomi territoriale të bazuar në parime të pastra etnike. BeH është mbajtur si shtet i papërputhshëm për statusin e kandidatit të BE-së për atë arsye. Komuniteti ndërkombëtarë mund të bëjë shumë pak për të ndryshuar situatën në terren sapo të hapet ky skenar. Është shembulli i Bosnjës që tregon shumë se pa marrë parasysh praninë ndërkombëtare, decentralizimi disa-shtresor dhe autonomia mbi baza etnike është e pamundur që të menaxhohet.

Në vend të përmbylljes së çështjes së veriut me konturat aktuale të parashikuara nga Plani i Ahtisaarit, një "Ahtisaari Plus" do ta bëjë pikërisht të kundërtën. Ai do të legalizojë situatën ekzistuese në veri, duke mundësuar që hapësira autonome ligjrisht ta sfidojë shtetin e Kosovës në praktikë. Ai do të mbajë gjallë dëshirën e Beogradit dhe ogureve të tij në veri që një ditë rajoni të ndahet. Në këtë ambient të ri, debati dhe aktivitetet politike në jug të Ibrit do të zhvendosen nga çështjet me presion siç është ekonomia dhe zhvillimi shoqëror - duke përfshirë demokratizimin e përgjithshëm dhe sundimin e ligjit - në një debat nacionalist të tej-konsumuar për karakterin e shtetit dhe nevojën për një shtet të tillë. Kjo do të pengojë zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës dhe do të mbajë shoqërinë të përqendruar në çështje të padobishme në vend të përqendrimit në përparimin e çështjeve kyçe.

¹⁶ Statusi shtesë i veçantë (autonomi) i "Ahtisaari Plus" që është duke u përmendur ka të ngjarë të përfundojë si një autonomi territoriale për veriun duke ditur vërejtjen e Tadiqit për krijimin e "rajonit që quhet veri i Kosovës", e cila nënkupton një linjë të caktuar territoriale si edhe faktin se këto të drejta shtesë janë duke u negociuar për komunitetin që jeton vetëm në një zonë të caktuar, pothuajse të saktë, brenda territorit të Kosovës.

¹⁷ Kushtet për PSA dhe aplikimi për statusin e vendit kandidat

2.2. E ardhmja e serbëve të Kosovës

Autonomia "Ahtisaari Plus" do të bëjë që serbët e Kosovës të jenë komuniteti etnik i vetëm në Evropë që ka dy standarde brenda një shteti të vetëm. Shumica e tyre që jetojnë në jug të Ibrit, të cilët janë përshtatur me Planin e Ahtisarit si mënyra e vetme për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre, do të përballen me tradhti. Kjo do të dërgojë një mesazh të qartë tek dy të tretat e serbëve që jetojnë në jug të Ibrit se përpjekjet e tyre për tu integruar dhe për ta demokratizuar Kosovën nuk janë shpague. Mesazhi do të jetë po ashtu i qartë se mbështetja e radikalizmit duke refuzuar shtetin është mënyra për të gëzuar shumë më shumë të drejta dhe perspektiva për zhvillim. Prandaj, sigurimi i standardeve të dyfishta do të bëjë që shumica prej dy të tretave të kenë një shkallë më të ulët të të drejtave se sa pakica prej një e treta që jetojnë në veri. Kjo do të ndikojë negativisht te serbët që jetojnë në jug të Ibrit, mbi të cilët varet karakteri multietnik i shtetit.

Autonomia në veri do të shkatërronte përbërjen politike serbe në jug të Ibrit, duke diskredituar të gjithë udhëheqësit e moderuar serb të Kosovës. Për më shumë, një numër i njerëzve të zakonshëm do të iknin menjëherë, qoftë nga rritja e presionit që vjen nga shqiptarët lokal,¹⁸ qoftë prej një ambienti të ri politik për serbët e veriut, ose nga humbja e qartë e perspektivës për të jetuar një jetë të qëndrueshme në jug të Ibrit. Pjesa tjetër do ta shoh gradualisht ambientin e ri shoqëror e politik në Kosovë me armiqësi në rritje kundrejt tyre. Derisa përqendrimi i Serbisë, Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtarë në rënie zhvendoset vetëm në veri, duke përfshirë mos angazhimin e Serbisë për mbështetjen e shërbimeve sociale serbe në jug, Kosova, në ndërkohë, do të përballlet me shpopullim të konsiderueshëm të jugut nga serbët. Destinacioni i serbëve të zhvendosur gradualisht do të jetë veriu autonom dhe Serbia. Kjo përfundimisht dhe de facto do të çojë në krijimin e dy njësisve një-etnike të ndara në shtet, duke përfunduar si BeH-ja – një shembull i mirënjohur, në mesin e komunitetit ndërkombëtar, i një shteti jo-funksional.

Trashëgimia serbe në Kosovë, me pjesën më të madhe dhe më të rëndësishme të vendosur në jug, gjithashtu do të jetë e rrezikuar. Dispozitat e planit të Ahtisaarit për mbrojtjen speciale të Kishës Ortodokse Serbe(KOS), duke përfshirë ruajtjen e përgjithshme të trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe, do të jetë e pakuptimtë pas zhvendosjes së serbëve të Kosovës. Kisha Ortodokse Serbe refuzon autonominë për veriun kryesisht për shkak se e kupton se do të mbetet pa njerëzit në të cilët ata mbështeten dhe përfundimisht të kthehen në asgjë tjetër, pos relikte të mbrojtura. Kjo është arsyeja parësore pse lidhja e KOS-it në Kosovë kundërshton jo vetëm autonominë për veriun, por gjithashtu edhe çdo avancim të ekstraterritorialitetit të tyre. Realisht kjo e vë KOS-in kundër shtetit serb dhe interesave nacionaliste të Beogradit. Duke pasur para sysh lidhjen ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe shtetit, do të ketë pak shanse që ky hendek të bëhet tërësisht publik.

2.3. Shqiptarët e pakënaqur të Kosovës

Shqiptarët e Kosovës në përgjithësi e shohin Planin e Ahtisaarit si një kompromis për të pasur legjitimitet të plotë ndërkombëtar për shtetin e pavarur. Ai e ka ulë nacionalizmin shqiptarë menjëherë pas pavarësisë, dhe ka krijuar ambient të sigurt për serbët në jug të Ibrit. Autonomia potenciale për veriun, duke nënkuptuar shkuarjen përtej kompromisit që tashmë është bërë, do të shpreh një pakënaqësi të përgjithshme publike duke ri-hapur një debat publik rreth asaj se çfarë shteti është Kosova, dhe si do të trajtohet ky status i ri. Duke ditur kompromisin famëkeq që është bërë për përfaqësimin rajonal të Kosovës

¹⁸ Tashmë ka grupe të armatosura të pakënaqura që shfaqen rastësisht përreth Kosovës dhe në zonat kufitare. Shih për shembull: Koha, "Zarfe me nënshkrime të AKSH-së për serbë të Klinës" 16 May, 2012, <http://www.koha.net/index.php?page=1.13.99721>.

me fusnotën, autonomia për veriun do të ishte, për shumicën shqiptare, jo vetëm famëkeqe por do të ishte një goditje përfundimtare për elitën politike të tanishme, të cilët ka gjasa që me konsensus të bëjnë kompromis për një përfundim të tillë.

Kjo, si rezultat, do të sigurojë më shumë hapësirë për diskursin nacionalist për të triumfuar pas një pozicioni të dobët në “mbrojtjen e çështjeve kombëtare” nga elita e tanishme politike. Ka shumë gjasa që ekstremistët, në mesin e shqiptarëve të Kosovës, do të fitojnë terren dhe të organizohen për të kërkuar reciprocitet për statusin e Luginës së Preshevës dhe trojeve shqiptare në Maqedoni. Zërat dhe kërkesat për shkëmbim territorësh në mes të Kosovës dhe Serbisë¹⁹ dhe ndryshimin e kufijve të tjerë për t’iu bashkuar Shqipërisë do të rriten. Pakënaqësia në mesin e ekstremistëve nuk do të shprehet vetëm përmes formës së organizuar, por edhe asaj të paorganizuar (spontane) që do të ishte e vështirë të menaxhohet. Në një trazirë të tillë të brendshme, Kosova do jetë ideale për rritje të radikalizmit nga forcat të cilat do të donë të de-legjitimojnë përbërjen e re të shtetit me veriun autonom. Për më shumë, tabloja e tanishme politike do të shpërbëhet, duke siguruar hapësirë për paraqitjen e forcave të reja nacionaliste, pikërisht para zgjedhjeve e përgjithshme të 2014-ës.

Në vend të qetësimit të rajonit, veriu autonom i Kosovës (Ahtisaari Plus) do të kontribuojë drejtpërdrejt në jo-stabilitetin afatmesëm dhe afatgjatë rajonal. Pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës siç është përcaktuar në planin e Ahtisaarit ishte njëri nga faktorët kyç në stabilizimin e rajonit në kuptimin që ka zbutur pretendimet për zgjidhje territoriale gjetiu nëpër Ballkan. Fillimisht kjo ka pasur efekt në pakicën shqiptare në jug të Serbisë dhe në Maqedoni, të cilët janë ujdisur me Marrëveshjen e Konçullit përkatësisht me Kornizën e Marrëveshjes së Ohrit. Pozicioni i tyre do të ndryshojë pasi që pakënaqësitë në Kosovë do të kenë ndezur kërkesat e tyre për bashkim me Kosovën (rasti i Preshevës) dhe të drejta më të avancuara dhe status më të lartë (rasti i Maqedonisë).

3. Serbia Jugore (Lugina e Preshevës)

Lugina e Preshevës, një rajon prej 1,267 km²²⁰ që i referohet tri komunave (Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje)²¹ në Serbinë Jugore, ka një popullatë totale prej 88,996, me një popullsi shumicë shqiptare prej 57,686, ose 65%.²² Ka qenë një nga pikat e nxehta në rajon sa herë që janë ngritur çështjet lidhur me Kosovën. Ajo është e lidhur organikisht me Kosovën; sa herë që ndonjë krizë madhore shpërthente në Kosovë, apo ngriheshin pasiguri rreth statusit të saj, ajo drejtpërdrejt ndikonte në ambientin politik dhe shoqëror në Luginë.

3.1. Lidhja me Kosovën: momentet kryesore

Prej vitit 1990 deri më 1992 shqiptarët në ish-Jugosllavinë socialiste organizuan partitë e tyre politike dhe themeluan këshillin e përbashkët koordinues politik. Ky këshill pat krijuar platformën e përbashkët që orvatej të ofronte zgjidhje për popullatën shqiptare që jetonte në Jugosllavi, e cila ishte në proces të shpërbërjes. Që prej asaj kohe kjo lidhje është shënuar me disa zhvillime të gjëra politike, të cilat kanë formësuar situatën aktuale në Luginë:

¹⁹ Heqja dorë nga veriu autonom i Kosovës për tërë Luginën e Preshevës

²⁰ Zona e Luginës së Preshevës është e ngjashme me zonën që mbulon katër komunat në pjesën veriore të Kosovës

²¹ Përbërja etnike e secilës prej tri komunave është si në vijim: Presheva – 88% shqiptar, 8% serb, 4% rom;

Bujanovc – 55% shqiptar, 34% serb, 7% rom; dhe Medvegja – 67% serb, 26% shqiptar, 3% malazez, dhe 1% rom.

²² BIRN Serbia, “South Serbia Demographics”, 24 mars, 2011, <http://www.balkaninsight.com/en/article/south-serbia-demographics>

1. *Referendumi (1992)*: Në prag të krizës politike në Kosovë dhe statusit të paqartë të shqiptarëve në Serbi, ishte organizuar referendumi jozyrtar në Luginë, ku shumica dërmuese pat shprehur vullnetin për bashkim me Kosovën. Që prej atëherë, kjo pjesë gjithnjë e më fuqishëm ka marrë konotacionin si “Kosova Lindore” për të reflektuar lidhjen e tyre organike me Kosovën. Edhe pse kjo lëvizje nuk pat çuar deri te ndonjë rezultat serioz, ajo pat shënuar lëvizjet e para politike në Luginë që në mënyrë të drejtpërdrejtë patën reflektuar krizën dhe ngjarjet tjera në Kosovë.
2. *Kryengritja e UÇPMB-së²³ (2000-2001)*: Lëvizja e dytë kryesore në Luginë që ka reflektuar lidhjet e saja me Kosovën është organizimi i lëvizjes së armatosur shqiptare kundër Serbisë nën emërtimin e UÇPMB-së, që filloi në janar të vitit 2000 – gjashtë muaj pas përfundimit të luftës në Kosovë. Sidoqoftë dëshirat e shqiptarëve për të bashkuar Luginën me Kosovën ranë në hije pas Deklaratës së Konçulit, të arritur me diplomacinë e udhëhequr nga SHBA-ja dhe NATO-ja në maj të vitit 2001, që i jep fund edhe konfliktit.
3. *Deklarata e Konçulit dhe Plani i Çoviçit (2001)*: shpërndan UÇPMB-në dhe lejon rihyrjen e strukturave të sigurisë së Serbisë në perimetrin prej 5 kilometrash të Zonës së Sigurisë Tokësore (GSZ). Deklarata e Konçulit gjithashtu çon deri te krijimi i Planit të Çoviçit²⁴, i cili parasheh platformën për zhvillimin ekonomik të Serbisë jugore sikurse edhe krijimin e një force multi-etnike dhe ri-integrimit e komunitetit shqiptar në institucionet publike duke përfshirë edhe gjyqësorin.
4. *Bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës (2005-2007)*: Komuniteti shqiptar në Luginë bëhet i zhurmshëm gjatë bisedimeve për statusin e Kosovës në Vjenë në vitet 2005-2007 – ngase dëshirojnë zgjidhje reciproke për Luginën në rast të pajtimit për ndarjen e pjesës veriore të Kosovës.²⁵
5. *Pavarësia e Kosovës (2008)*: Pavarësia e Kosovës dhe efektet e më pasme të saj sjellin një ambient të ri për Luginën. Përkundër deklaratave se kufijtë në Ballkan nuk mund të ndryshohen, Prishtina dhe Beogradi duke përfshirë edhe disa figura politike nga Lugina e Preshevës mbajnë biseda sekrete mbi mundësinë e shkëmbimit të territoreve ndërmjet veriut dhe Luginës. Këto bisedime dështojnë për shkak të kundërshtimit të liderit shqiptar në Maqedoni (Ali Ahmeti), i cili mendon se zgjidhja e tillë do të kishte efekt negativ për shqiptarët e Maqedonisë.
6. *Dialogu Prishtinë – Beograd (2011- 2012)*: Prej shtatë “konkluzioneve” të dialogut, janë dy të cilat do të mund të lehtësonin drejtpërdrejtë pozitën e shqiptarëve etnik në Luginë – i) njohja e ndërsjellë e diplomave universitare dhe ii) liria e lëvizjes. Megjithatë, derisa e para nuk po zbatohet, e dyta po e bën edhe më të vështirë lirinë e lëvizjes. Përveç policës së shtrenjtë të sigurimit të automjeteve – që më parë nuk paguhej – dy nga katër pikat kufitare zyrtare²⁶ mes Kosovës dhe Luginës nuk mund të përdoren.

²³ Ushtria Çlirimtare e Preshevës Medvegjës dhe Bujanovcit – The Liberation Army of Presevo, Medvedja, and Bujanovac.

²⁴ E quajtur sipas ish zv. kryeministrit të Serbisë, Nebojsa Çoviç dhe është e bazuar në katër shtylla:

- 1) Eliminimi i kërcënimeve ndaj sovranitetit të shtetit dhe integritetit territorial;
- 2) Siguri, liri të lëvizjes dhe të drejtën për tu kthyer në Luginën e Preshevës, përmes çarmatosjes dhe shpërbërjes së “terroristëve” dhe “demilitarizimit të rajonit”;
- 3) Zhvillimi i shoqërisë multi etnike dhe multi konfesionale; dhe
- 4) Zhvillimi Ekonomik dhe Social.

²⁵ Presheva Jonë, “Southern Serbia (Presevo Valley): The Second Kosovo?”

<http://www.preshevajone.com/southern-serbia-presevo-valley-the-second-kosovo/>. Shih gjithashtu: Huszka, Beata “The Presevo Valley if Southern Serbia alongside Kosovo: Case for Decentralisation and Minority Protection: CEPS Policy Brief No. 120, janar 2007, <http://aei.pitt.edu/11714/1/1428.pdf>, p. 7.

²⁶ Merdar (porta 3) dhe Dheu i Bardhë (porta 5) janë ato që mund të përdoren, derisa Mutivoda (porta 4) – që lidh Prishtinën direkt me Medvegjinë dhe Muçibaba – që lidh Gjilanin direkt me Preshevën (porta 6) nuk janë të përfshira si pjesë e marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë; kështu që nuk mund të përdoren.

3.2. Kushtet aktuale sociale të shqiptarëve

Plani i Çoviçit përpos që ka sjellë një numër të projekteve të mbështetura nga donatorët, nuk ka arritur që të prodhoj shumë ngase ky rajon ka trashëguar një gjendje të ngecjes për shumë dekada. Komuniteti shqiptar në Luginë ende vazhdon të jetë i nën përfaqësuar në institucionet publike, sidomos në polici dhe në gjyqësor.²⁷ Arsyet janë të dyfishta. E para është elementi jo-diskriminues: kur një pozitë në institucionet publike është e siguruar për shqiptarët, disa nga ta refuzojnë që të marrin pjesë në punë të tilla²⁸ dhe ekziston perceptimi i përgjithshëm se ata janë të pakualifikuar për disa nga pozitat në institucionet publike.²⁹ E dyta është elementi diskriminues ku për shembull në konkursin për 60 zyrtarë policorë të nivelit më të ulët në Preshevë janë punësuar vetëm 3 shqiptarë, pavarësisht nga fakti se konkursi kishte për synim angazhimin e zyrtarëve potencial policorë të komunitetit shqiptar.³⁰

Efektet diskriminues është i dukshëm edhe në procesin e privatizimit në Serbi, në të cilin shumë pak ndërmarrës shqiptarë kanë pas hapësirë për të investuar në privatizimin e disa prej ndërmarrjeve në pronësi shoqërore të vendosura në zonat me shumicë shqiptare.³¹ Pamundësia e shqiptarëve etnik për tu integruar tërësisht në institucionet shtetërore dhe publike, që njëherësh shihen si punëdhënësit kryesorë, vetëm sa e vështirëson jetesën e tyre. Shkalla e lartë e papunësisë (60% në Bujanovc dhe 70% në Preshevë)³² dhe mungesa e një të ardhme prosperuese çojnë kah shpopullimi i vazhdueshëm i shqiptarëve, kryesisht të rinjve të Luginës.³³

Shkalla e lartë e papunësisë në sektorin publik gjithashtu e vështirëson zbatimin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe për shkak të mungesës së personelit shqipfolës. Serbia ka miratuar Ligjin mbi minoritetet kombëtare në vitin 2002, duke i bërë zyrtare gjuhët e minoriteteve në komunat ku ata përbëjnë 15% të popullatës.³⁴ Si rezultat i këtij ligji gjuha shqipe është bërë gjuhë zyrtare në Preshevë dhe Bujanovc,³⁵ dhe më vonë në Medvegjë.³⁶ Pavarësisht nga vështirësitë fillestare dhe rezistencës ndaj zbatimit të ligjit, gjatë kohës ka pasur ca përparime megjithëse të ngadalshme. Megjithatë, pak kohë më parë në 2011-ën ka pas mospërfillje të ligjit nga ana e institucioneve qendrore shtetërore. Dokumentet e reja biometrike të identifikimit nuk janë lëshuar në gjuhën shqipe (e as në ndonjë gjuhë tjetër minoritare) në Serbi dhe për shembull në zgjedhjet e 6 majit fletëvotimet nuk janë shtypur në gjuhën dhe alfabetin lokal. Liderët shqiptarë në Luginë këtë pengesë ia kanë atribuuar rolit nacionalist të Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) në qeverinë qendrore të Serbisë dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në veçanti.

Natyra e problemeve të tilla në Luginë ka krijuar hapësirë për paraqitjen e grupeve të pakënaqura dhe mes tjerash të bëhen edhe të dhunshme. Grupi i ri i armatosur “Lëvizja e

²⁷ Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë politik në Luginë. Preshevë dhe Bujanovc, 24 maj 2012. Sipas Beata Huszka nga CEPS Policy Brief në gjykatën komunale në Bujanovc 4 nga 44 punëtorët janë shqiptarë dhe të tjerët janë serbë, derisa në gjykatën komunale të Preshevës 11 nga 40 punëtorët janë shqiptarë, 3 romë dhe 24 serbë.

²⁸ KIPRED intervistë me zyrtar të lartë politik, Bujanovc, 24 maj 2012.

²⁹ KIPRED intervistë me të rinj të zakonshëm, Preshevë dhe Bujanovc, 24 maj 2012.

³⁰ KIPRED intervistë me një përfaqësues të ri shqiptar të njëres prej partive politike udhëheqëse në Luginë. Preshevë. 24 maj 2012.

³¹ KIPRED intervistë me zyrtar të lartë të Kosovës, 31 maj 2012.

³² Huszka, Beata “The Presevo Valley if Southern Serbia alongside Kosovo: Case for Decentralisation and Minority Protection: CEPS Policy Brief No. 120, janar 2007, <http://aei.pitt.edu/11714/1/1428.pdf>, p.3.

³³ KIPRED intervista me krerët e partive politike dhe aktivistë lokal, 15 maj 2012, Bujanovc dhe Preshevë,

³⁴ RFJ tani Serbi: Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të minoriteteve kombëtare, <http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/refugees/SaMsocialrights/law%20on%20minorities.pdf>, p.4.

³⁵ Huszka, B. “The Presevo Valley” <http://aei.pitt.edu/11714/1/1428.pdf>, p.3.

³⁶ Misioni OSBE-së në Serbi “Ethnic Minorities in Serbia: An Overview”, shkurt 2008, <http://www.osce.org/serbia/30908>, p.7.

Lirisë” është paraqitur më 17 maj 2012 duke kryer sulme mbi punktin policor serb në fshatin Dobrosin³⁷ të Bujanovcit – vendin e njëjtë ku kishte lindur UÇPMB-ja.

Sulmet gjoja se ishin kryer nga vija kufitare Kosovë - Serbi, 20-50 metra në largësi nga punkti policor.³⁸ I njëjti grup sulmoi një tjetër pikë kontrolli të policisë në Dobrosin më 28 qershor 2012 ku një oficer policie u lëndua lehtë.³⁹ Janë përdorur armë të ndryshme në të gjitha këto sulme nga pushkët automatike, snajperët, dhe armë të tjera të kalibrit të lartë.⁴⁰ Ka shumë pak gjasa që këso lloj grupesh të armatosura të jenë në gjendje të avancojnë të drejtat e shqiptarëve në Luginë. Sidoqoftë, ato paraqesin kërcënim real për paqen dhe stabilitetin në Luginë. Ata kanë mundësi të jenë më agresiv kur të shohin se nuk do të ketë reciprocitet ose ndonjë të drejtë shtesë dhe status për shqiptarët lokal pas autonomisë së dhënë për Kosovën veriore.

3.3. Dinamikat e politikës lokale në Luginë pasqyrojnë Kosovën

Udhëheqja shqiptare në Luginë mbetet e lidhur organikisht dhe shumë e sinkronizuar me udhëheqjen politike në Kosovë. Të gjitha partitë kryesore politike lokale në Luginë kanë lidhje direkte me partitë kryesore politike në Kosovë, për arsye të ndryshme nga ato ideologjike e historike deri te ato më të ngushta për përfitime afatshkurtra.⁴¹ Përveç partisë së moderuar Partia për Veprim Demokratik (PVD) e cila ka pasur lidhje historike me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe Lëvizja për Progres Demokratik (LPD) parimisht kanë mbajtur dhe vazhdojnë të mbajnë lidhje të afërta me partitë e dala nga UÇK-ja përkatësisht PDK dhe AAK.

Si rezultat i vdekjes së Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe ndarjet pasuese në LDK, lidhjet e PVD-së së Riza Halimit me LDK-në gradualisht janë zbehur. Në anën tjetër PDK dhe AAK vazhdojnë të mbajnë lidhjet e tyre të forta me PDSH, LPD dhe Unionin Demokratik Shqiptar (UDSH), dhe fraksioni i ndarë nga PVD-së i shndërruar në Partia Demokratike (PD)⁴² në të cilën interesat politike nuk kanë qenë arsyeja e vetme, por edhe ato të biznesit – në kuptim të pasjes së të njëjtit sponsor që operon në të dyja anët. Këto marrëdhënie kanë formësuar direkt sjelljen politike në të dyja kampet – derisa PVD ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet kombëtare dhe lokale në Serbi, kampi tjetër ka bojkotuar në vazhdimësi zgjedhjet kombëtare të Beogradit por ka marrë pjesë në zgjedhjet komunale. Gjatë dekadës së kaluar udhëheqja shqiptare në Luginë “e ka ndjerë vetën të jetë nën presion të politikanëve nga Kosova për të bojkotuar të gjitha zgjedhjet kombëtare serbe me shpresën se do të forcohet rasti i ‘Kosovës Lindore’”.⁴³ Ky reciprocitet mund të shihet gjithashtu në regjistrimin e 2011-ës ku shqiptarët e Luginës së Preshevës bojkotuan regjistrimin e popullsisë, duke reflektuar bojkotin e serbëve të veriut në veri të Ibrit.

Sapo fituan PDK-ja dhe AAK-ja pozita udhëheqëse në Prishtinë, po ashtu ndodhi edhe me partitë “simotra” në Luginë. Kjo zhvendosje e pushtetit politik, sidoqoftë nuk ka rezultuar në ndonjë përpjekje substanciale të Prishtinës për t’i ndihmuar shqiptarët në Luginë. Nuk ka pasur ndihmë në fushën e edukimit, zhvillimit ekonomik dhe

³⁷ Agjencia Indeksonline, “Lëvizja e Lirisë” merr përgjegjësinë”, 18 maj, 2012, <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=19768>.

³⁸ B92, “Junge says attackers ‘intended to kill’ policemen”, 17 maj 2012, http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2012&mm=05&dd=17&nav_id=80291.

³⁹ Portali Info.AL, “Bujanoc, sulmohet rajoni i policies, merr përsipër ‘Lëvizja e Lirisë’”, 28 qershor, 2012, <http://info.al/v5/2012/06/bujanoc-sulmohet-rajoni-i-policise-merr-persiper-levizja-e-lire/>.

⁴⁰ NOA Magazina, “Sulmohet me mitralozë policia serbe, Lëvizja e Lirisë merr përgjegjësinë”, 18 maj, 2012, <http://noa.al/news/artikull.php?id=187074>.

⁴¹ KIPRED intervistë me Kamberi, G. activist lokal dhe gazetar në Luginë të Preshevës, 15 maj 2012, Tirana.

⁴² PD ndahet nga PVD në 2011, dhe ka mbështetje dominante në Bujanovc.

⁴³ GNK 2003, Southern Serbia’s Fragile Peace, p.23; KIPRED intervistë në Luginë të Preshevës, maj 2012.

investimeve, ose në përfaqësimin e interesave politike të shqiptarëve të Luginës. Në ndërkohë, derisa Serbia vazhdon të investojë deri në qindra miliona euro në vit për komunitetin serb në Kosovë, kryesisht në pjesën veriore, Kosova nuk ka investuar as edhe një kompjuter për komunitetin shqiptarë në Luginë.⁴⁴

Mbështetja politike është zbehur edhe me kalimin e kohës, veçanërisht me dhe pas (1) nënshkrimit të Deklaratës së Konçulit, (2) gjatë negociatave për statusin e Kosovës në Vjenë, (3) me miratimin e Planit të Ahtisarit, dhe së fundi (4) me dialogun e tanishëm që po vazhdon mes Prishtinës dhe Beogradit. Për shembull, përfaqësuesit e partive më të mëdha shqiptare në Luginë nuk kanë marrë ndonjë mbështetje nga homologët e tyre të Kosovës, kur ata shtynin deklaratën e tyre të shtatorit 2007 për të zbatuar parimet e Planit të Ahtisarit në Luginë si masë të reciprocitetit.⁴⁵ Pozicioni i udhëheqjes shqiptare në Luginë ka qenë gjithmonë *reciprociteti* me serbët e Kosovës. Që kur reciprociteti i kërkuar nuk mundi dhe nuk do të mund të zbatohet në Luginë, edhe pozita e shqiptarëve ka ndryshuar. Ata tani kanë filluar të kërkojnë të njëjtin status për Luginën e Preshevës të cilin veriu i Kosovës mund ta marrë.

Udhëheqja aktuale politike shqiptare në Luginë nuk është në gjendje që të zhvillojë një politikë autonome; takimet ndërmjet drejtuesve politik të Kosovë dhe Luginës janë shumë të rralla dhe të kufizuara në përfitimet afatshkurtra politike - zakonisht para zgjedhjeve. Udhëheqësit politik në Luginë mbeten të ndarë aq sa udhëheqësit politik në Kosovë kur vjen puna për të rënë dakord mbi ndonjë lëvizje të madhe kombëtare. Ata nuk lëvizin përtej fokusit të tyre të kufizuar dhe afatshkurtër dhe përfitimeve politike brenda kufijve të tyre komunal apo të komunitetit, me përqendrimin primar në çështjet lokale. Në fund të fundit, ata mbesin të varur nga politikanët e Kosovës për të ardhmen e tyre, si dhe për të ardhmen e zonës. Në këtë mënyrë, shqiptarët në Luginë janë bërë bixhë e qendrave politike dhe ideologjive në Prishtinë. Por, duke pasur parasysh mungesën e mbështetjes nga ana e Prishtinës, ata janë përdorur në mënyrë efektive si një kartë politike për çfarëdo zgjidhje që ka të bëjë me veriun e Kosovës.

3.4. Autonomia e Veriut të Kosovës dhe Lugina: Shpalosja e Skenarëve

Në vijim janë skenarët që ka gjasa të ndodhin po qe se autonomia (Ahtisaari Plus) jepet për veriun.

SKENARI I: Rezultatet e këtij skenari janë mos ndryshimi i kufijve aktual, pa ngjarje destabilizuese rajonale në afat të shkurtër; zhvendosje e heshtur dhe graduale e njerëzve; krijimi i dy entiteteve-etnike brenda Kosovës; një Kosovë jofunksionale; dhe ngjarje të mundshme destabilizuese rajonale në periudhë afatmesme dhe afatgjate:

1. Autonomia (Ahtisaari Plus) i është dhënë pjesës veriore të Kosovës;
2. Funkcionaliteti i Kosovës si shtet është vënë në pikëpyetje, komponentët multi-etnik për në jug ka pak gjasa që të zbatohen dhe të avancohen; procesi i integritetit evropian ndalet;
3. Nuk mund të bëhet asnjë përparim për statusin e shqiptarëve në Luginë, asnjë përmirësim social prej saj, dhe një përqindje e rritur e shpopullimit të zonës, disa prej tyre duke gjetur strehim drejt Evropës, dhe shumica e tyre në Kosovë në jug të Ibrit;

⁴⁴ KIPRED intervista me shumë personalitete në udhëheqjen partiake në Luginë.

⁴⁵ Deklarate Politike e KKSHLP, 29 shtator 2007, në "Serbia: Maintaining Peace in the Presevo Valley", Europe Report NO. 186, 16 tetor, 2007, <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/serbia/186-serbia-maintaining-peace-in-the-presevo-valley.aspx>, p.7.

4. Përbërja politike shqiptare në Luginë përpiqet të kërkojë më shumë të drejta, por nuk marrin mbështetje nga homologët e tyre të Kosovës dhe më pak nga bashkësia ndërkombëtare;
5. Këto ngjarje dhe situata e re e krijuar rishtas detyron dy të tretat e serbëve në jug të Ibirit që disa prej tyre të shkojnë menjëherë dhe disa gradualisht drejt pjesës veriore dhe Serbisë;
6. Shumica prej 4,000 shqiptarëve në veri shpërngulen drejt jugut;
7. Krijohet një karakter i ri i Kosovës me dy pjesë etnikisht homogjene, me lumin Ibër që i ndan dy etnitetet;
8. Karakteri i ri i shtetit do të prish shumë dispozita tjera të Planit të Ahtisaarit duke e bërë atë të parëndësishme për jugun dhe të ndryshëm për veriun;
9. "Shtetësia" dhe funksionimi i Kosovës me kufijtë e saj aktual dhe një karakter i ri (dy pjesë mono-etnike) e bëjnë të pamundur për të ecur përpara me reformat si një shtet i vetëm me karakterin e tij "multi-etnik" siç është paraparë në Planin e Ahtisaarit , dhe rrjedhimisht i paaftë për të përmbushur shumë prej kushteve bile edhe aplikimin për statusin e kandidatit të BE-së e lëre më marrjen e tij.

SKENARI II: Rezultatet e këtij skenari janë ndezja e pakënaqësisë së konsiderueshme popullore në mesin e shqiptarëve në Kosovë dhe në Luginë; de-legjitimimi i udhëheqjes në Kosovë dhe Luginë; krijimi i një vakuumi të rrëmbyer nga lëvizjet dhe retorika aktuale dhe të reja nacionaliste; shfaqja dhe intensifikimi i grupeve të pakënaqura dhe të rastësishme të armatosura; një Kosovë jo-funksionale; dhe fillimi i proceseve politike dhe negociatave që çojnë në një Ballkan të destabilizuar:

1. Autonomia (Ahtisaari Plus) i është dhënë pjesës veriore të Kosovës;
2. Ndezja e një pakënaqësie të kufizuar te shqiptarët, kryesisht te të rinjtë, në Luginë;
3. Funksionimi i Kosovës sipas Planit të Ahtisaarit është vënë në pikëpyetje; komponentet multi-etnike për jugun ka më pak gjasa që të zbatohen dhe të avancohen;
4. De-legjitimimi i udhëheqjes së Kosovës (një elitë politike që zhytet në konsensus për Ahtisaari Plus) që çon në një de-legjitimimi të menjëhershëm të udhëheqjes dhe elitës politike në Luginë si një reflektim nga de legjitimimi në Kosovë;
5. Rënia e popullaritetit të elitës aktuale politike në Kosovë dhe në Luginë, dhe krijimi i vakuimit politik;
6. Pakënaqësia e manifestuar në Kosovë që do të thelloj pakënaqësinë tashmë të ndezur në Luginë; vakuumi i rrëmbyer nga lëvizjet dhe retorika nacionaliste çojnë në një situatë ku negociatat politike të llojeve të ndryshme në mes Kosovës dhe Serbisë materializohen;
7. Përkeqësohet situata e sigurisë;
8. Ri-hapja e negociatave politike me udhëheqjen e de-legjitimuar vetëm sa do të krijojnë më shumë përçarje me nacionalistët, të cilët do të duan të kenë një zë në shumicën e lëvizjeve politike duke e bërë më të vështirë arritjen e koncesioneve;
9. Një popullaritet i rritur për shpërbërjen e shtetit dhe bashkimin me Shqipërinë; shqiptarët e Kosovës kërkojnë ndarje;
10. Krijimi i një situatë të paqëndrueshme në Ballkan me Evropën e paaftë për ta menaxhuar.

4. Maqedonia

Maqedonia paraqet një rast tjetër nga ai i Luginës, kur është fjala për efektet anësore të autonomisë potenciale për pjesën veriore të Kosovës. Derisa çështja me shqiptarët në jug të Serbisë është e kufizuar në komunitetin shqiptar që jeton në Luginë, çështja me Maqedoninë është e ndryshme nga konteksti i përgjithshëm demografik, gjeografik dhe social në të gjithë shtetin. Çështja e komunitetit shqiptar në Maqedoni dhe vetë çështja mbetet paksa e shkëputur nga të dyja, Kosova dhe Lugina; platformat politike dhe aspiratat e shqiptarëve kanë mbetur kryesisht në kuadrin e integritit brenda shtetit maqedonas dhe të kufizuara në marrjen e më shumë të drejtave si qytetarë të barabartë brenda shoqërisë. Zërat për shpërbërjen, shkëputjen, ose ri-bashkimin me një shtet tjetër kanë qenë dhe mbeten të kufizuara. Shembull i rastit është deklarimi i "Republikës së Iliridës" nga shqiptarët në Maqedoninë Perëndimore, pasi e bojkotuan referendumin e shtatorit 1991 për pavarësi të Maqedonisë.

Komuniteti shqiptar në Maqedoni jeton përgjatë pjesës perëndimore dhe veri-perëndimore të Maqedonisë. Përveç kësaj, ka rreth 10 herë më shumë shqiptarë në Maqedoni se në Luginë, në bazë të regjistrimit maqedonas të vitit 2002,⁴⁶ janë 509,083 shqiptarë, ose më shumë se 25%, në mesin e 2,022,547 banorëve të popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë.⁴⁷

Ndryshe nga komunat me shumicë shqiptare të Luginës që drejtpërdrejt kufizohen me Kosovën, komunat me shumicë shqiptare në Maqedoni janë të shpërndara në mënyrë jo të rregullt përgjatë rajonit verior (në kufi me Serbinë - Luginën), veri-perëndimor (në kufi me Kosovën), dhe perëndimor (në kufi me Shqipërinë) të Maqedonisë.⁴⁸ Gjashtëmbëdhjetë nga 84 komuna në Maqedoni, janë ato që përbëhen nga shumica shqiptare, apo më pak se 20 për qind e të gjitha komunave. Këto 16 komuna mbulojnë një sipërfaqe prej 3,156 km² nga hapësira e përgjithshme prej 25.713 km² m e të gjithë vendit, ose 12% e të gjithë territorit të Maqedonisë.⁴⁹

Pikërisht në këtë kontekst, ndryshe nga shqiptarët në Luginë, këta në Maqedoni e kanë gjetur veten në një pozicion më dominues si pakica më e madhe në vend, ose siç i referohet zakonisht si "shumica e dytë", që kur Maqedonia u pavarësua në vitin 1991. Shqiptarët gjithashtu kanë marrë pjesë vazhdimisht në proceset politike të vendit dhe kanë qenë pjesë e çdo koalicion qeveritar, që kur vendi u bë i pavarur. Diskriminimi i atëhershëm politik dhe shoqëror nuk ishte në masën që ishte në Kosovë në vitet 1990 kur Maqedonia u bë e pavarur. Para pavarësisë së saj, megjithatë, ndërsa shqiptarët në Kosovë gëzonin të drejta shumë më të gjera, shqiptarët në Maqedoni ishin të

⁴⁶ Republika e Maqedonisë, Enti Shtetëror i Statistikave, Regjistrimi i Popullsisë, Amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë, 2002.

⁴⁷ Të dhënat e vitit 2002 konsiderohen me të meta dhe të motivuara politikisht nga shumica. Shqiptarët deklarojnë se përfaqësojnë së paku 30 për qind të popullsisë në Maqedoni. Regjistrimi i ri i gjerë shtetëror që kishte nisur në tetor të vitit 2011 është ndërprerë pasi që anëtarët e Komisionit shtetëror të regjistrimit dhanë dorëheqje për shkak të mosmarrëveshjeve rreth procesit ndërmjet partnerëve të koalicionit – VMRO-DPMNE maqedonase dhe BDI-së shqiptare.

⁴⁸ Edhe pse kryesisht të përqendruara në veri-perëndim të Maqedonisë, jo të gjitha komunat me shumicë shqiptare kufizohen me njëra-tjetrën - mungon lidhja e drejtpërdrejtë, dhe kështu janë përhapur në shumë entitete të ndara "enklavore" në kufi me tre vende të ndryshme fqinje. (1) Likova dhe Haraçina qëndrojnë së bashku në pjesën veriore të Maqedonisë në kufi me Kosovën dhe me Luginën përmes Likovës. (2) Studeniçan qëndron vetëm në jug të Shkupit, dhe (3) Çairi gjithashtu qëndron vetëm brenda Shkupit, të dyja këto nuk kufizohen me komunat tjera me shumicë shqiptare dhe as me ndonjë prej vendeve kufitare. (4) Saraj, Zhelinë, Brvenica, Vrapçisht, Bogovinë, Gostivar, Oslomej, Zajas, Tearcë dhe Tetovë përbëjnë koleksionin më të madh të komunave me shumicë shqiptare duke qëndruar së bashku në pjesën veri-perëndimore të Maqedonisë në kufi me Kosovën kryesisht nëpër Tetovë, Tearcë, Vrapçisht, Bogovinë, dhe Gostivar, dhe Shqipëri përmes Gostivarit. (5) Dibra dhe Struga qëndrojnë ngushtë së bashku në pjesën perëndimore të Maqedonisë në kufi me Shqipërinë përmes të dyja komunave.

⁴⁹ Ky është rezultat i ripërcaktimit të kufijve komunal në vitin 2004 si pjesë e zbatimit të Kornizës së Marrëveshjes së Ohrit, që konsiderohet se i ka sjellë dobi pozitës shqiptare që ka fituar numër më të madh komunash.

diskriminuar në atë masë që ata ishin privuar nga përdorimi i emrave shqiptarë për të sapolindurit. Pikërisht për këtë arsye gjeneratat e vjetra të shqiptarëve në Maqedoni kanë emra shumë më tepër me kuptim myslimanë se të gjitha komunitetet e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.⁵⁰ Kjo ishte mënyra e vetme për ta ruajtur identitetin e tyre kombëtar, duke e lidhur atë pazgjidhshmërisht me fenë, një tipar që i dallon ata nga shqiptarët e tjerë.

4.1. Momentet kryesore për shqiptarët në Maqedoni

Para se Maqedonia të shpallte pavarësinë e saj, shqiptarët kishin krijuar tashmë partitë e tyre politike, si kudo në ish-Jugosllavi. Pas dekadash të diskriminimit të rëndë, partitë politike shqiptare kërkuan një përparim të konsiderueshëm të të drejtave si të barabartë në shtetin e ri. Zërat për shkëputje mbetën të kufizuar.

1. *Fillimi i pluralizmit (1990)*: Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partia Demokratike Popullore (PDP) themelohen⁵¹. Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), krijon një qeveri teknokratike - e para në periudhën post-komuniste, që përjashton shqiptarët.
2. *Maqedonia shpall pavarësinë (1991)*: Shqiptarët bojkotojnë referendumin për pavarësi, pasi nuk kishte asnjë garanci për përparimin e të drejtave të tyre dhe përfundim të diskriminimit. Kushtetuta e re e shpalli shtetin e ri si "shtet kombëtar i popullit maqedonas".
3. *Referendumi shqiptar (1992)*: Shqiptarët mbajnë një referendum për krijimin e "Republikës së Iliridës", si një mjet për barazi të plotë brenda Maqedonisë, duke krijuar një entitet shqiptar. Përbërja politike maqedonase e pa këtë si një përpjekje për shkëputje. Shqiptarët formulojnë kërkesat kyçe politike.⁵²
4. *Qeveria e re në Shkup (1992)*: Bashkimi Social Demokratik i Maqedonisë (SDSM) krijon një qeveri, e cila përfshin PPD-në shqiptare. Kjo nuk avancoi pozitën e shqiptarëve në Maqedoni.
5. *Ndarja e shqiptarëve (1994)*: Anëtarët më radikal të PPD-së krijojnë një parti të re - Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH). Partia e re nuk mund të regjistrohet, për shkak të frikës së përbërjes maqedonase nga një parti e re nacionaliste. Anëtarët e partisë së re garuan në zgjedhje dhe morën ulëse në Kuvend, si kandidatë të pavarur. As kjo nuk avancoi pozitën e shqiptarëve në Maqedoni.
6. *Forcimi i shqiptarëve "ekstremistë" politik (1996)*: "nacionalistët" shqiptar - PPDSH fituan në shumicën e komunave të mbizotëruara nga shqiptarët.⁵³
7. *Krijimi i një force të re politike shqiptare (1997)*: PPDSH dhe PPD bashkohen për të formuar Partinë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH). Katër kryetarë shqiptar të komunave arrestohen për shkak të përdorimit publik të flamurit kombëtar

⁵⁰ KIPRED intervista në Shkup 1 qershor, 2012

⁵¹ Rexhepi, januar 2008, "Themelimi i partive politike në Maqedoni", The Zeqirija Rexhepi Blog, <http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/themelimi-i-partive-politike-n-maqedoni.html>

⁵² (1) heqja e preambulës së Kushtetutës themeluese që e ka shpallur Maqedoninë "një shtet kombëtar të popullit maqedonas", (2) t'i jepet një status partneri-kombëtar – për vendimmarrje të përbashkët me maqedonasit në nivele shtetërore dhe lokale; (3) përfaqësimi proporcional i shqiptarëve në institucionet shtetërore; (4) përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe; (5) përdorimi publik i flamurit shqiptar, dhe (6) krijimi dhe më vonë legalizimi i një universiteti shtetëror në gjuhën shqipe - e cila ishte bërë një kërkesë thelbësore, si rezultat i mbylljes së Universitetit të Prishtinës në vitin 1989 nga regjimi serb.

⁵³ Bogdan Szajkovski, Elections and Electoral Politics in Macedonia, 1999.

shqiptar; PDSH braktis institucionet duke përfshirë qeverisjen e komunave. Forca e re, përsëri, nuk mund të avancojë pozitën e shqiptarëve në Maqedoni.

8. *Nacionalistë nga të dyja kampet etnike bashkohen për të formuar një qeveri (1998-2002)*: Nacionalistët maqedonas VMRO-DPMNE bashkuan forcat me ekstremistët shqiptarë të PDSH-së për të krijuar një qeveri koalicioni. Kryetarët e komunave shqiptare kthehen në zyrat e tyre. Megjithatë, meqë pozita e shqiptarëve nuk përparon shumë, dhe ankesat vetëm sa shtohen sulmet në stacionet e policisë maqedonase ndodhin më 1998, 1999 dhe 2000 - dhe atëbotë e panjohura *Ushtria Çlirimtare Kombëtare* (UÇK) merr përgjegjësinë.⁵⁴
9. *Lufta në Kosovë dhe fushata e NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) (1999)*: Lufta në terren në mes UÇK-së në Kosovë dhe forcave të RFJ-së intensifikohet. NATO fillon fushatën ajrore kundër objektivave të RFJ-së. Forcat e RFJ-së filluan spastrimin etnik dhe qindra e mijëra shqiptarë të Kosovës gjejnë strehim në Maqedoni.
10. *Konflikti i armatosur (2001)*: Përleshjet në mes të UÇK-së në Maqedoni dhe forcave të sigurisë maqedonase intensifikohen; vendi sillet në prag të një lufte të plotë civile. UÇK-ja në Maqedoni kërkon barazi të plotë për shqiptarët, dhe përsërit kërkesat e njohura politike shqiptare. BE dhe SHBA ushtrojnë presion mbi opozitën maqedonase dhe shqiptare respektivisht në LSDM-në PPD-në të bashkohen në qeverinë VMRO-DMNE/PDSH për të negociuar dhe për të arritur një konsensus të përgjithshëm për të adresuar kërkesat e shqiptarëve etnik; në fund ata bashkohen. Partitë shqiptare në qeveri i kërkojnë UÇK-së në Maqedoni të çarmatoset, por Ali Ahmeti, si udhëheqës i UÇK-së në Maqedoni, u la jashtë këtyre negociatave politike, konflikti thellohet edhe më tej.
11. *Marrëveshja e Ohrit (2001)*: BE/SHBA sponsorizojnë Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, e cila ishte e mundur vetëm pas përfshirjes së Ali Ahmetit në këtë proces. Unifikimi i partive politike shqiptare dhe UÇK- së bëhet e mundur vetëm me përfshirjen e aktorëve të pavarur politik të Kosovës, Veton Surroi dhe Ylber Hysa, të cilët ndërmjetësuan në mes UÇK-së në Maqedoni dhe partive shqiptare PDSH-së dhe PPD-së si dhe diplomatëve kryesor amerikan dhe evropian.⁵⁵. Shumica e kërkesave të shqiptarëve janë të përfshira në Marrëveshjen e Ohrit.
12. *Nga lufta në politikë (2002)*: Shqiptarët propozojnë krijimin e Këshillit Koordinues të shqiptarëve - të udhëhequr nga figura të UÇK-së. Këshilli dështon për shkak të përpjekjeve të PDSH-së për të rrëmbyer udhëheqjen e Këshillit.⁵⁶ Si rezultat, Ali Ahmeti i UÇK-së në Maqedoni përgjigjet me krijimin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), i cili, pas zgjedhjeve të përgjithshme 2002, i bashkohet SDSM-së maqedonase për të krijuar qeverinë e koalicionit.
13. *Shpërthejnë tensionet ndëretnike (2012)*: Prej muajit shkurt deri në maj ndodhin incidente të shumta në të gjithë vendin duke përfshirë rrahje, vrasje, protesta jo

⁵⁴ Iso Rusi, From Army To Party: The Politics of The NLA, <http://www.isn.ethz.ch/isn/Digital-Library/Publications/Detail/?ots591=0c54e3b3-1e9c-be1e-2c24-a6a8c7060233&lng=en&id=44474>, fq. 1.

⁵⁵ Diplomatët amerikanë dhe britanikë në ambasadat e tyre përkatëse në Shkup kanë qenë kundër përfshirjes së cilësdo figurë të UÇK-së në negociatat politike. Ata ishin të etiketuar si grup terrorist në mesin e diplomatëve të BE-së dhe zyrat gjithashtu. Bashkëbiseduesit kosovarë, së bashku me diplomatin amerikan Robert Forwick luajtën një rol të madh në arritjen e një marrëveshjeje të armëpushimit, formulimin e kërkesave politike për një marrëveshje të paqes dhe marrëveshjen e përgjithshme që të përfshihen figurat kyçe të UÇK-së në marrëveshjen politike, e cila përfundimisht çoi deri te Marrëveshja e Ohrit.

⁵⁶ Iso Rusi, fq. 14.

vetëm mes dy etnive, por edhe në mes të popullit dhe oficerëve të policisë. Në prill organizohen dy protesta multi-etnike duke mbledhur mijëra njerëz që kërkojnë paqe dhe jetë të përbashkët.

4.2. Ndikimi i Marrëveshjes së Ohrit në pozitën e shqiptarëve

Rezultatet e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit kanë qenë në përgjithësi pozitive. Shqiptarët morën vetë-qeverisjen në komuna, duke përfshirë përdorimin zyrtar të gjuhës në komunat ku ata përbëjnë 20% e më shumë të popullsisë.⁵⁷ Gjuha shqipe mund të përdoret gjithashtu në Parlament. Gjuha e përdorur në gjykata dhe sistemin gjyqësor është kryesisht ajo maqedonase, por shqiptarët kanë të drejtë të përdorin përkthimin. Përdorimi i flamurit kombëtar, ku shqiptarët përbëjnë shumicën është gjithashtu e lejuar. Për më tepër, asnjë ligj në lidhje me identitetin ose interesat shqiptare nuk mund të kalojë pa miratimin e shumicës së shqiptarëve të përfaqësuar në Parlament.

Si rezultat i Marrëveshjes së Ohrit, ridefinimi i kufijve komunalë u realizua në vitin 2004. Ri-definimi i kufijve, i cili nga maqedonasit u perceptua si dobiprurëse për shqiptarët u kundërshtua me protesta dhe me një referendum pasues i cili dështoi.⁵⁸ Krijimi i suksesshëm i komunave të reja i bëri shqiptarët shumicë e përgjithshme në 16 komuna, ndërsa në 13 komuna të tjera ata përbëjnë më shumë se 20%, por më pak se 50%, duke e bërë kështu gjuhën shqipe zyrtare në 29 komuna.⁵⁹

Universiteti në gjuhën shqipe është legalizuar në vitin 2003. Gjithashtu, ka pasur një rritje të përfaqësimit të shqiptarëve në kuadër të institucioneve publike. Para konfliktit përfaqësimi i shqiptarëve në institucionet shtetërore dhe publike ishte 3 për qind.⁶⁰ Sipas Avokatit të Popullit të Maqedonisë ky numër ishte 8.3% në vitin 1997 dhe 10.2% në vitin 2000. Aktualisht, përfaqësimi i shqiptarëve në institucionet publike qëndron në 16 për qind.⁶¹

Edhe me efektet pozitive të Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarët mbeten ende të pabarabartë dhe të papërfaqësuar në fusha të ndryshme në shtet. Për shembull, shqiptarët mbeten shumicë në mesin e më shumë se 30 % të papunëve.⁶² Gjithashtu, shqiptarët që jetojnë në komunat ku ata janë më pak se 20% e popullsisë përballen me probleme si: përdorimi i gjuhës në administratën publike, qasja në arsimim në gjuhën e tyre amtare, dhe shpesh janë viktimë të diskriminimit, përfshirë edhe nga zyrtarët publikë.⁶³ Një problem tjetër në arsim është se ai është i ndikuar shumë nga partitë politike;⁶⁴ mësuesit dhe profesorët marrin pozitat e tyre në bazë të përkatësive partiake. As studentët nuk janë të mbrojtur nga ndikimet e tilla, as titujt dhe bursat nuk janë gjithmonë të bazuar në meritë, por ato janë të ndikuara nga përkatësia partiake.

⁵⁷ Aisling Lyon, "Municipal Decentralisation in the Republic of Macedonia: Preserving a Multi-Ethnic State?", 2011, http://federalgovernance.co/archives/volume8/FG_VOL8_ISS3_LYON.pdf.

⁵⁸ Referendumi dështoi për shkak të numrit të vogël të votuesve. Nuk ishte arritur përqindja e duhur prej 50+1 të daljes, e cila ishte e domosdoshme për vlefshmërinë e referendumit.

⁵⁹ Për shembull numrat e shqiptarëve u rritën në Brvenica (nga 33% në 62,5%); Çair (nga 38.9% në 67.2%); Vrapçishtë (nga 0% në 82.4%).

⁶⁰ Arben Xhaferi, cituar nga Veton Surroi, "Libri i Fluturave", 2010, fq. 116

⁶¹ Aisling L., "Municipal Decentralisation"

http://federalgovernance.co/archives/volume8/FG_VOL8_ISS3_LYON.pdf

⁶² Grupi Ndërkombëtar për të drejtat e Minoriteteve, 5 shtator, 2011

<http://www.minorityrights.org/4025/macedonia/albanians.html>.

⁶³ Ibid.

⁶⁴ Ibid.

4.3. Pakënaqësitë dhe politika

Aktualisht, ka një agjendë divergjente në mes palëve në pushtet në Maqedoni, ku VMRO-DPMNE dhe BDI ndjekin agjendat e tyre të ndara. VMRO-DPMNE, përmes rishenjëzimit të identitetit maqedonas, po shpenzon rreth 500 milionë euro⁶⁵ për statuja dhe ndërtesa "klasike" në projektin Shkupi 2014. Udhëheqja e VMRO-DPMNE po e shtyn kartën e saj nacionaliste me implementimin e këtij projekti në komunën me shumicë shqiptare atë të Çairit në Shkup, duke shkaktuar një tjetërsim të plotë në mesin e popullatës shqiptare në kryeqytet. BDI, derisa po përpiqet të shërbej si një stabilizator, në të njëjtën kohë po e mbron pozicionin e saj në pushtet, nuk ka qenë në gjendje të absorbojë dhe drejtojë pakënaqësinë shqiptare. Partia është duke u akuzuar se është duke vepruar më shumë si një "vëzhguese e Kombeve të Bashkuara (OKB)" dhe jo si një hisedar në shtet.⁶⁶

Me një proces të bllokuar të anëtarësimit në strukturat euroatlantike, për shkak të kontestit të emrit me Greqinë fqinje, Maqedonia po përballet me tensionet më të këqija ndër-etnike që nga viti 2001. Vrasja e dy burrave shqiptarë nga një oficer i policisë maqedonase në Gostivar,⁶⁷ më 28 shkurt 2012, ndezi një seri aktesh të dhunshme ndër-etnike.⁶⁸ Rreth një javë më vonë, më 7 mars 2012, pesë njerëz të etnisë shqiptare janë rrahur në një autobus në Shkup.⁶⁹ Pak ditë më vonë shqiptarët u kundërpërgjigjën duke sulmuar dhe rrahur të moshuarit dhe të rinjtë në rrugë.⁷⁰ Incidentet e tilla vazhduan në baza ditore të cilat u pasuan me arrestime. Këto veprime janë shoqëruar edhe nga disa protesta në të gjithë vendin nga të dy grupet etnike, duke kënduar parulla nacionaliste dhe shoviniste kundër njëri-tjetrit. Gjithashtu, në mars një koktej molotovi u hodh në Ambasadën e Maqedonisë në Prishtinë.

Këto ngjarje kulmuan me vrasjen - nga meshkuj shqiptar - e 5 meshkujve të përkatësisë etnike maqedonase, katër prej tyre të rinj të cilët ishin duke peshkuar në liqenin afër Shkupit dhe një të moshuar që po qëndronte. Kjo vrasje tronditi vendin, duke çuar në protesta anti-shqiptare në të gjithë vendin. Për t'i bërë gjërat edhe më keq, Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë (MPB) pohoi, pas kryerjes së disa bastisjeve dhe arrestimeve, se 5 viktimat ishin ekzekutuar nga grupe terroriste myslimane. Të gjithë individët e arrestuar ishin të përkatësisë etnike shqiptare dhe disa ish-anëtarë të UÇK-së nga meshkuj shqiptar.⁷¹ Një qasje e tillë nga ana e zyrtarëve maqedonas u prit keq jo vetëm nga myslimanët por edhe nga shqiptarët e Maqedonisë. Si rezultat, u organizuan dy protesta masive në Shkup, më e madhja, ajo më 11 maj 2012, kur 10.000 shqiptarë

⁶⁵ Sinisa Jakov, "Skopje 2014 Forge Ahead Despite Macedonian Crisis", Balkan Insight 7 qershor, 212, <http://www.balkaninsight.com/en/article/skopje-2014-forges-ahead-despite-macedonian-crisis>.

⁶⁶ KIPRED intervista në Shkup 1 qershor 2012.

⁶⁷ Burimet e KIPRED-it në Maqedoni theksojnë se polici maqedonas ka tërhequr këmbëzën e alltisë pasi që është sulmuar nga një grup i burrave shqiptarë para vajzës së tij përderisa po e parkonte veturën.

⁶⁸ Balkans Aljazeera, "Talas medjuetnickih incidenata u Makedoniji", 9 mars, 2012 <http://balkans.aljazeera.net/makale/talas-medjuetnickih-incidenata-u-makedoniji>.

⁶⁹ Ibid.

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Burimet e KIPRED-it me sponde të ndryshme në Maqedoni pohojnë se MPB-ja erdhi shpejtë në përfundim, sidomos me pretendimin se sulmet ishin kryer nga një grup terrorist. Grupet muslimane terroriste janë përmendur në mënyrë që të mos drejtohet me gisht pikë në një etni të caktuar (në këtë rast shqiptarët) dhe në këtë mënyrë të parandalojë eskalimin e më tutjeshëm të incidenteve ndër-etnike. Kjo gjoja do të bashkonte dy grupet etnike, shqiptarët dhe maqedonasit kundër "armikut" të përbashkët të sapokrijuar. Megjithatë, gazetarët të cilët kanë qenë në kontakt me MPB-në theksojnë se akuzat e Ministrisë janë të pabaza dhe se vrasja është bërë për arsye të problemit të pastër të pronësisë. Objektivi nuk ishin katër të rinjtë, por i moshuari, i cili sipas MPB-së ishte gjoja një dëshmitar. Krejt e kundërta. Në këtë kontest të pronës, objektivi ishte i moshuari, të cilit i ishte premtuar prona nga qeveria aktuale, e cila më parë i ishte dhënë me qira një shqiptari dhe katër të rinjtë kanë qenë viktimat duke qenë dëshmitarë të një akti të tillë penal.

spontanisht⁷² dolën në rrugë dhe thërrisnin slogane fetare ("Myslimanët nuk janë terroristë") dhe nacionaliste ("Shqipëria e Madhe").

Spontaniteti i protestave në Shkup, prapa të cilave nuk kanë qenë asnjëra prej partive më të mëdha politike shqiptare, BDI dhe PDSH, krijon hapësirë për krijimin e një lëvizje alternative politike të shqiptarëve që janë të pakënaqur me përbërjen e tyre politike.⁷³ Aktualisht, BDI e Ali Ahmetit dhe VMRO-DPMNE e Gruevskit pasqyrojnë një freski të ngjashme me rehatinë e koalicionit PDSH-VMRO-DPMNE që kishte para konfliktit të vitit 2001. Hapësira që është duke u krijuar për një lëvizje alternative frikëson përbërjen politike shqiptare në pushtet, komoditeti i të cilëve po lëkundet nga ngjarjet e fundit.

Pakënaqësia dhe de-legjitimimi me të cilën përbërja politike shqiptare është duke u përballur ka çuar tashmë në zëra që kërkojnë federalizimin e Maqedonisë dhe krijimin e Kuvendit dy-dhomësh, si një minimum i cili do të garantojë barazinë e etnisë shqiptare.⁷⁴ Këto zëra do të rriten ndërkohë që ata të organizohen në baza të forta politike, të cilat pjesa maqedonase i sheh si një kërcënim për ndarjen dhe si rezultat shpërbërjen e shtetit. Përbërja e tanishme politike shqiptare nuk do të shtroj kërkesa të tilla, megjithatë partia politike në pushtet BDI e cila gjithashtu udhëheq 15 nga 16 komuna me shumicë shqiptare, nuk do të bëjë asgjë as për të parandaluar këtë.⁷⁵ Kjo do t'i japë impuls popullaritetit në rritje të idesë për "Shqipëri etnike (e Madhe)" në mesin e një segmenti të popullsisë shqiptare.

Derisa shqiptarët shtynë për riorganizimin e shtetit, maqedonasit do të reagojnë me propozimin e tyre të mëparshëm për ndarjen e vendit. Federalizimi dhe Kuvendi i përbërë nga dy dhoma shkojnë përtej asaj që maqedonasit duan për shtetin dhe organizimin e brendshëm të tij. Ata më parë do të kishin një shtet të ndarë se sa një federal. Gjatë konfliktit të vitit 2001, udhëheqja e atëhershme e VMRO-DPMNE i ofroi PDSH-së një zgjidhje e cila parashihet ndarjen e vendit - ku një rrip i ngushtë i Maqedonisë veriperëndimore, të banuar nga shqiptarët, do të shkëputej dhe do të bashkohej ose me Kosovën ose me Shqipërinë. Në të njëjtën kohë, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve e propozoi një hartë të detajuar të ndarjes së vendit, e cila u miratua publikisht nga ana e VMRO-DPMNE-së. Sipas kryetarit të Akademisë, Georgi Efremov, plani do të ishte që shqiptarët të "vendoseshin në rajonet perëndimore të Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës të cilat më pas do t'i bashkoheshin vetë Shqipërisë në një datë të mëvonshme. Në shkëmbim, Shqipëria do t'i jepte Maqedonisë, qytetin e Pogradecit dhe zonën përreth liqenit të Prespës, ku jeton një pakicë e vogël maqedonase".⁷⁶ Ky propozim u refuzua nga Ali Ahmeti i UÇK-së në Maqedoni, i cili më shumë donte të vendoste për integrim se sa për ndarje.

Kjo e bëri Ali Ahmetin jo vetëm garantues të integritetit territorial të Maqedonisë, por edhe një faktor për stabilitetin rajonal dhe ruajtjen e kufijve rajonal shtetërorë. Ishte ai që në vitin 2010 e hodhi poshtë idenë e ndarjes së Kosovës dhe shkëmbimin e territoreve me Luginën gjatë bisedimeve sekrete midis qeverive të Kosovës dhe Serbisë, të ndihmuar nga disa politikanë të Luginës së Preshevës. Ahmeti e kundërshtoi fuqishëm këtë zgjidhje,⁷⁷ dhe deklaroi qartë se ai nuk do të garantojë as qëndrueshmërinë e Maqedonisë as atë të rajonit. Ai e vlerësoi një zgjidhje të tillë si humbje të pozitës së shqiptarëve në

⁷² KIPRED intervista të shumta në Shkup dhe Tetovë, 31 maj, 1 dhe 6 qershor, 2012.

⁷³ KIPRED vërejtjet gjatë vizitave të shumta në Maqedoni, maj, qershor 2012.

⁷⁴ KIPRED intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë në Shkup dhe Tetovë, qershor 2012.

⁷⁵ KIPRED intervistë me zyrtar të lartë të BDI-së, Tetovë, 31 maj 2012.

⁷⁶ Veton Latifi, "Storm Over Macedonia Partition Plan", Institute for War and Peace Reporting, 6 qershor, <http://iwpr.net/report-news/storm-over-macedonia-partition-plan>

⁷⁷ KIPRED intervistë me Ali Ahmetin, Reçicë e Vogël, 31 maj 2012.

Maqedoni, sepse kjo do të çonte në ndarjen e Maqedonisë në pjesë, të cilat në realitet nuk do të përfshinin as përafërsisht atë çka pretendojnë shqiptarët si të tyre. Qëndrimi i tij u mbështet fuqimisht nga kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha. Anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare tërhoqën mbështetjen e tyre pasive për ndarje, duke e mbyllur temën për momentin.

4.4. Autonomia e Kosovës Veriore dhe Maqedonia: Shpalosja e skenarëve

Në vijim janë skenarët që ka gjasa të ndodhin po qe se arrihet pajtimi për autonominë (Ahtisaari Plus) e veriut.

SKENARI I: Rezultatet e këtij skenari janë mos ndryshimi i kufijve të tanishëm; asnjë ngjarje rajonale destabilizuese në afat të shkurtër; ideja e Kuvendit të përbërë nga dy dhoma dhe federalizimi bëhen pjesë e rrjedhës së përgjithshme; protestat e ndërsjella etnike dhe urrejtja ndër-etnike zënë vend; Maqedonia bëhet politikisht e paqëndrueshme; ngjarjet rajonale destabilizuese shfaqen në periudhë afatmesme deri afatgjate:

1. Autonomia (Ahtisaari Plus) i është dhënë pjesës veriore të Kosovës;
2. Funkionimi i Kosovës sipas Planit të Ahtisaarit është vënë në pikëpyetje; komponentët multi-etnik për jugun kanë më pak gjasa që të zbatohen dhe të avancohen;
3. Zërat e pavarur dhe individual (mediet, akademikët, shoqëria civile), ri-hapin debatin rreth statusit të shqiptarëve në Maqedoni dhe një reciprociteti të mundshëm në Maqedoni;
4. Kërkesat për krijimin Kuvendit të përbërë nga dy dhoma dhe federalizim hasin në terren të përshtatshëm të mbështetjes në mesin e shqiptarëve, të cilët tashmë janë të pakënaqur, dhe udhëheqja e tyre politike përballet me zbehje të legjitimitetit;
5. Zhvillohen protesta të ndërsjella; zëra nacionalistë maqedonas kundërshtojnë kërkesa të tilla duke kënduar e shprehur parulla nacionaliste dhe anti-shqiptare. Po kështu shqiptarët me prejardhje të ndryshme, një përzierje e nacionalistëve dhe atyre të grupeve fetare, gjejnë arsye për të marrë rrugët për këto kërkesa të reja dhe të shprehin pakënaqësinë e përgjithshme;
6. Përbërja politike e të dy kampeve, maqedonase dhe shqiptare, sidomos ata në koalicionin qeverisës përpiqen të minimizojnë efektet, opozita politike nga të dyja kampet përpiqet të marrë përsipër kauzën.

SKENARI II: Rezultatet e këtij skenari janë kërkesat e rritura për ndryshimin e kufijve të tanishëm; ngjarje rajonale destabilizuese; Maqedonia bëhet e paqëndrueshme dhe udhëheqja ndërrohet; një lëvizje e tretë dominante shqiptare lind si alternativë; rajoni bëhet i paqëndrueshëm:

1. Autonomia (Ahtisaari Plus) i është dhënë pjesës veriore të Kosovës;
2. Ideja për Kuvend dy dhomësh dhe federalizim bëhet më e fortë derisa grupi i pakënaqur në Kosovë marshon në solidaritet me grupet e pakënaqura në Maqedoni;
3. Përbërja e paqëndrueshme politike në Maqedoni çon në zgjedhje të parakohshme duke ndryshuar tablonë politike;
4. Në vend krijohet një konsensus i përgjithshëm shqiptar për federalizim;
5. Rifillojnë negociatat politike në Maqedoni me të dërguar perëndimor në rolin e vëzhguesve dhe ndërmjetësuesve;

6. Periudha e negociatave intensifikon edhe më tepër pakënaqësinë;
7. Udhëheqësit maqedonas përsëri propozojnë ndarjen e vendit; duke reflektuar zërat në Kosovë për ndarje të vërtetë dhe të plotë të veriut të Ibrit dhe kërkesat në rritje për shpërbërjen e shtetit dhe bashkimin me Shqipërinë rriten.

5. Akterët e mbetur rajonal dhe të tjerë ndërkombëtarë

5.1. Akterët rajonal

Krijimi i një rajoni autonom në veri të Kosovës do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në sjelljen dhe zhvillimet e dy akterëve tjerë të rajonit – Shqipëria dhe BeH-ja. Shqipëria ka qenë shteti më kooperues me agjendën ndërkombëtare për rajonin në dy dekadat e fundit. Ajo ka mbështetur pa kundërshtim Marrëveshjen e Dejtonit, Pëlqimin e Rambujesë, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Deklaratën e Konçullit, Marrëveshjen e Ohrit, Planin e Ahtisaarit dhe çdo zgjidhje tjetër që ishte sponsorizuar nga bashkësia ndërkombëtare. Sidoqoftë, gjatë dekadës së kaluar, Shqipëria ka fituar status dhe pozicion tjetër në rajon. Ajo ka kaluar nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik⁷⁸ dhe është bërë pjesë e NATO-s, duke i kontribuar më tutje stabilitetit dhe sigurisë vendore.

Megjithatë, shkëputja politike dhe sociale që kishte ekzistuar ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të ish-Jugosllavisë socialiste kohëve të fundit po ndryshon. Shqipëria fuqishëm e mbështet pavarësinë e Kosovës dhe në mënyrë të vazhdueshme lobon për njohjen e saj. Gjithashtu po tenton që të luaj rol stabilizues në Maqedoni dhe në Luginë. Derisa nacionalizimi është rritur në rajon gjatë disa viteve të fundit, edhe Shqipëria ka rritur rolin e saj “nacional” në rajon. Në pajtim me Nenin 8 të Kushtetutës së saj, Shqipëria ka filluar që të përqendrohet në “ruajtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të saj”.⁷⁹ Për shembull, ambasadori i Shqipërisë në Kosovë pak kohë më parë publikisht ka kritikuar të gjithë ata që mbështesin konceptin e “kombit kosovar” duke konsideruar se kjo është një përpjekje për të rishikuar historinë dhe identitetin e shqiptarëve.⁸⁰ Në të njëjtën kohë ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni ka pranuar në zyrën e tij kreun e një familjeje etnike shqiptare të zhvendosur nga Velesi dhe publikisht ka thënë se Shqipëria do të angazhohet në ruajtjen e interesave të shqiptarëve të prekur në Maqedoni, duke akuzuar në mënyrë të tërthortë lidërshtimin e BDI-së për mosangazhim të duhur.⁸¹ Kjo qasje e re nga Tirana tregon se shteti jo vetëm që ka vullnetin por edhe është i aftë që të bëhet një lojtar më aktiv në çështjet shqiptare jashtë kufijve të saj dhe të riformuloj rolin e saj në rajon.

Bosnja paraqet shembullin më të zymtë të shtetit të brishtë dhe jofunksional, që ka rezultuar nga shkurtpamësia e bashkësisë ndërkombëtare dhe paaftësia për vendosjen e mirëfilltë të paqes, demokracisë dhe zhvillimit në Ballkanin Perëndimor. Marrëveshja e Dejtonit e sponsorizuar ndërkombëtarisht ka sjellë përfundimin e luftës por në të njëjtën kohë ka krijuar një shtet jo-nfunktional me dy entitete – Entiteti boshnjako-kroat i Federatës së BeH-së, të përbërë nga 10 kantone; Entiteti serb Republika Srpska (RS); dhe

⁷⁸ Për shembull: GDP-ja e Shqipërisë e ka tejkaluar atë të Maqedonisë në vitin 2000, aktualisht më shumë se 1.2 miliardë euro më shumë. Për më tepër, buxheti i Shqipërisë kohë më parë e ka kaluar atë të Maqedonisë, aktualisht duke qëndruar në më shumë se 0.4 miliardë euro më shumë.

⁷⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 8, Paragrafi 1.

⁸⁰ “Lauka: S’ka komb kosovar”, Gazeta Express, 11 qershor 2012,

<http://www.gazetaexpress.com/?cid=1.13.83653>.

⁸¹ “Maqedoni, dëbimi i shqiptarit”, Top Channel Albania, 19 qershor, 2012 <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=236907&ref=ml>.

distriktin multietnik të Brçkos. Ky rregullim i komplikuar shtetëror i kontribuon në masë të madhe paralizimit të shtetit, krahas ekzistimit të antagonizmave të shumta etnike edhe 17 vjet pas luftës. Pos sabotimit të RS-së për kohezion më të madh në BeH, kroatët për vite të tëra kanë kërkuar njësinë e tyre territoriale etnike dhe ri-rregullimin e shtetit. Për këtë, kroatët e kanë mbështetur e heshtur të disa prej vende kryesore të BE-së.⁸²

Një BeH e tillë ballafaqohet me bashkësinë e ndarë ndërkombëtare. BE-ja e ka kushtëzuar aplikimin e Bosnjës për anëtarësim me mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (OHR), e cila mbyllet me kushtin që BeH-ja të krijoj institucione të qëndrueshme qendrore, kusht ky që po refuzohet nga RS-ja, e mbështetur nga Serbia dhe Rusia. BE-ja në parim kërkon mbylljen e OHR-së dhe është e gatshme që të bëjë kompromis me RS-në, por po përballet me kundërshtinë e SHBA-ve dhe të Turqisë. Me përçarjet ndërmjet mbikëqyrësve të BeH-së – SHBA-të, BE-ja, Rusia dhe Turqia, forcat centripetale brenda shtetit do të rriten, gjë që do t'i kontribuoj që BeH-ja të mbetet shtet i dobët, që funksionon kryesisht mbi vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare.

5.2. Akterët ndërkombëtarë

Qasja e bashkërenduar nga akterët kryesorë ndërkombëtarë ka sjellë paqen në Ballkanin Perëndimor para më shumë se një deкаде. Paqja dhe stabiliteti u bënë *modus operandi* të përfshirjes ndërkombëtare, duke u përqendruar vetëm në qëllimet afatshkurtra. Kjo mungesë e vizionit strategjik e ka sjellë rajonin në gjendjen e tanishme – jostabile, nacionaliste, pa institucione të vërteta demokratike dhe me probleme, të cilat nuk mund të zgjidhen me konsensusin e munguar ndërkombëtar. Derisa BE-ja po përballet me probleme ekonomike dhe SHBA-të që po e zhvendosin vëmendjen strategjike jashtë Evropës, Rusia po e përdor këtë vakum për të avancuar interesat e saja. Kjo situatë i komplikon edhe më tej çështjet në rajon.

SHBA-të kanë paralajmëruar zhvendosjen e tyre strategjike nga Evropa, duke përfshirë edhe Ballkanin, për në Azi e Paqësor. Gjithashtu e kanë bërë të qartë se Ballkani është problem i Evropës. Megjithatë, edhe pas më shumë se 20 vitesh nga shpërbërja e Jugosllavisë, BE-ja nuk ka arritur që të krijoj një politike të jashtme të unifikuar në raport me Ballkanin. Si për ironi, Ballkani është problemi i vetëm, me të cilin është përballur BE-ja kur ka qenë e paaftë për të reaguar në mënyrë të pavarur dhe i është dashur lidhshipi amerikan për ta qetësuar oborrin e vet. Dhe janë pikërisht luftërat në Ballkan që e kanë bërë të vetëdijshme BE-në për nevojën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Edhe pas dy dekadash të përfshirjes në rajon, Bashkimi Evropian nuk ka arritur që të krijoj një qasje të përbashkët për Ballkanin. Ende ka mungesë thelbësore të një vizioni strategjik të përgjithshëm për rajonin; problemet me njohjen e Kosovës nga pesë vendet anëtare, dhe qasja e përçarë drejt zgjidhjes për pjesën veriore të Kosovës; paaftësia e saj për të lëvizur përpara me procesin e anëtarësimit për Maqedoninë për shkak të mosmarrëveshjeve të kësaj të fundit me Greqinë; pos dhënies së statusit të kandidatit për Serbinë, ka qenë e paaftë që të ruaj forcat pro-evropiane në vend për shkak të shpërbërjes totale me realitetet në Serbi; ndarje e plotë në lidhje me rregullimin e ardhshëm të Bosnjës; dhe paaftësia për të përdorur “karotën” e anëtarësimit për të ndikuar në kulturën politike të ndërtimit të konsensusit në Shqipëri dhe për të siguruar zgjedhje të lira dhe të drejta.

Mungesa e efektivitetit të BE-së e ka formësuar qasjen e Bashkimit ndaj rajonit në një proces teknik të reformave. Kjo qasje do të jetë e paqëndrueshme dhe nuk do ti

⁸² KIPRED intervistë me diplomatët evropianë dhe të BeH-së, Sofje, Bullgari 8 qershor, 2012.

kontribuoj as stabilitetit e as demokracisë dhe zhvillimit të rajonit. E përballur me problemet e veta ekonomike dhe ngritjen e forcave të djathta politike, ajo nuk ka energji për të mbështetur reformat thelbësore në atë masë sa kishte tentuar të bënte deri në vitin 2008. Kështu që është e qartë se Bashkimi Evropian nuk është i aftë për tu marrë vetë me rajonin. Sidoqoftë, me zhvendosjen strategjike të SHBA-së – duke e lënë Ballkanin në duart e Evropës – BE-ja do të duhet që të merret vet me Ballkanin.

Rusia e sheh Ballkanin si një rajon strategjik dhe edhe pse nuk mund të garoj me ndikimin e BE-së dhe të SHBA-së, Moska ende përpiqet që të zhvilloj interesat dhe ndikimin e saj duke përdorur dobësinë e Perëndimit. Tenton ta bëjë këtë duke mbështetur Serbinë si partnerin e saj kryesor rajonal dhe duke minuar arkitekturën e përgjithshme të Perëndimit ndaj rajonit. Moska nuk mund të ‘fal’ që ishte lënë anash (për shkak të dobësive të saja të brendshme) gjatë viteve të 90’ta dhe veçanërisht fushatën e sulmeve ajrore të NATO-s ndaj atëherë ish RFJ-së. Megjithatë, gjatë dekadës së kaluar Rusia është rimëkëmbur edhe ekonomikisht edhe politikisht. Ajo e përdor ndikimin e saj global për të ndaluar shtetet që ta njohin pavarësinë e Kosovës; mbështet kërkesat e RS-së në BeH; dhe në mënyrë të heshtur katër vjet më parë ka propozuar federalizmin e Maqedonisë. Në këtë mënyrë, Rusia me efektivitet po mundohet që të turpëroj Perëndimin për mungesën e ‘sukseseve’ të tij në rajon.

6. Skenari përfundimtar

Fuqitë perëndimore janë lodhur me Ballkanin. Ata i shohin marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës si çështje të fundit të pazgjidhur në rajon dhe po kërkojnë ‘normalizim’ marrëdhëniesh mes të dyjave, më pak se njohja e ndërsjellë. “Çmimi” për këtë normalizim është autonomia për pjesën veriore të Kosovës. Duke marrë parasysh dinamikën rajonale, kjo autonomi e parashikuar nuk do të çoj kah stabiliteti më i madh, por më shumë në kahje të kundërt. Do të krijoj skenën për edhe një përfshirje ndërkombëtare pas 5-10 viteve, me shumë me pak legjitimitet dhe besim nga lojtarët vendor rajonal dhe nga njerëzit e rajonit. Duke i marrë për bazë dinamikat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, autonomia për veriun e Kosovës sipas të gjitha gjasave do të shpie kah skenari në vijim:

SKENARI: Rezultatet e skenarit të mundshëm janë mos ndryshimi i kufijve në afat të shkurtër; ngjarje destabilizuese rajonale; shkëmbim i heshtur dhe gradual i njerëzve; krijimi i entiteteve dy-etnike brenda Kosovës dhe një Kosovë jofunksionale; tensionet në Luginën e Preshevës që çojnë te zhvendosja e heshtur e shqiptarëve etnik; bisedime të reja politike nisin në Maqedoni për të federalizuar shtetin, duke i kontribuar jostabilitetit të brendshëm; Bosnja paralizohet pasi që RS-ja dhe kroatët e BeH-së propozojnë platformë të përbashkët për riorganizimin e shtetit; shtohen zërat për ridefinimin e kufijve në Ballkan bashkë me rritjen e ndjenjave nacionaliste në tërë shtetet e rajonit; Evropa nuk mundet që ti menaxhojë këto ngjarje e paaftë që të lëviz përtej platformës aktuale të garës së anëtarësimit; roli i SHBA-ve zbehet, por orvatet që të udhëheq nga prapavija;

1. *Kosova:* Autonomia (Ahtisaari Plus) i është dhënë pjesës veriore të Kosovës;
2. *Kosova:* Funkcionaliteti i Kosovës si shtet është vënë në pikëpyetje; komponentët multi-etnik për jugun ka më shumë gjasa që nuk zbatohen dhe nuk avancohen; procesi i integritit evropian stagnon;
3. *Lugina e Preshevës:* Tensionet ndëretnike rriten; asnjë përparim nuk mund të bëhet për statusin e shqiptarëve në Luginë, e si pasojë as përparim social, dhe një shtim i

përqindjes së shpopullimit të zonës, një pjesë e të cilëve kërkon strehë në Evropë dhe pjesa dërrmuese tjetër në jug të Kosovës;

4. *Maqedoni*: Zërat e pavarur dhe individual (media, akademikët, shoqëria civile) rihapin debatin për statusin e shqiptarëve në Maqedoni dhe reciprocitetin e mundshëm në Maqedoni me pozitën e veriut të Kosovës duke përfshirë marrëdhënie speciale me Kosovë dhe Shqipëri;
5. *Kosovë*: Këto ngjarje dhe situata e re e krijuar në Kosovë shtyn dy të tretat e serbëve në jug të Ibrit të lëvizin në mënyrë graduale drejt Serbisë dhe pjesës veriore të Ibrit;
6. *Kosovë*: Tanimë të harruar, pjesa dërrmuese e 4,000 shqiptarëve në veri lëvizin drejt jugut;
7. *Kosovë*: Një karakter i ri për Kosovën është krijuar me dy pjesë homogjene etnike, dhe me lumin Ibër që i ndan të dy etnitë;
8. *BeH*: Kroatët e BeH-së bëjnë presion për krijimin e entitetit kroat në shtet, duke kërcënuar me bllokimin e tërësishëm të institucioneve të Federatës dhe të institucioneve qendrore të BeH-së, RS-ja i përkrah ata;
9. *Kosovë, Lugina e Preshevës, Maqedoni*: Lidershipi i Kosovës humb legjitimitetin, dhe me të edhe lidershipi në Luginë dhe Maqedoni gjithashtu; rritet popullariteti për bashkim me Shqipërinë;
10. *Maqedoni*: Kërkesat shqiptare për krijimin e Kuvendit dy-dhomësh dhe federalizimin e plotë të shtetit gjejnë terren të përshtatshëm në mesin e shqiptarëve tashmë të pakënaqur të Maqedonisë; lidershipi politik shqiptar përballet me zbehjen e legjitimitetit;
11. *Kosovë dhe Maqedoni*: Grupet e pakënaqura shqiptare në Kosovë marshojnë në solidarizim me grupet e pakënaqura të shqiptarëve të Maqedonisë;
12. *Maqedoni*: Do të zhvillohen protesta të dyanshme (vështirë të dihet përmasa) - Zëra nacionalistë maqedonas duke kundërshtuar kërkesa të tilla thërrasin parulla nacionaliste dhe anti-shqiptare. Po kështu shqiptarët me prejardhje të ndryshme, një përzierje e nacionalistëve dhe atyre në mesin e grupeve fetare, gjejnë shkas për të marrë rrugët për këto kërkesa të reja dhe shprehin pakënaqësinë e përgjithshme, qeveria bie duke çuar vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme; shteti ballafaqohet me stagnim të plotë të procesit të integritimit Evropian;
13. *BeH*: Bosnja mbetet e paralizuar, një platformë e përbashkët për riorganizimin dhe funksionimin e mëtejshëm të shtetit propozohet nga RS dhe kroatët; boshnjakët i refuzojnë kushtet;
14. *Kosovë*: "Shtetësia" dhe funksionimi i Kosovës me kufijtë e saj aktual dhe një karakter i ri (dy pjesë mono-etnike) e bëjnë të pamundur për të ecur përpara me reformat si një shtet të vetëm me karakterin e tij "multi-etnik" siç është paraparë në Planin e Ahtisarit, dhe kështu nuk është në gjendje të përmbushë shumë prej kushteve bile edhe për aplikimin për statusin e kandidatit të BE-së e lëre që ta marrë atë.
15. *Maqedonia*: Zgjedhjet radikalizojnë të dy kampet, ku partitë shqiptare kërkojnë federalizimin e plotë të Maqedonisë, partitë maqedonase fillojnë të marrin parasysh përsëri idenë e ndarjes së vendit;
16. *Maqedonia*: Negociatat politike rifillojnë në Maqedoni me prezencë të dobët të të dërguarve përëndimor si vëzhgues dhe ndërmjetësues; periudha e negociatave rritet më tej pakënaqësinë e brendshme;

17. *Kosova dhe Maqedonia*: Zërat për ndarje reale të Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë rriten në mesin e shqiptarëve të Kosovës, duke ndikuar direkt në pozicionin politik negociues të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni;
18. *BeH*: RS njofton se do të mbajë një referendum mbi pavarësinë dhe bashkimin me Serbinë, kroatët shpallin krijimin e entitetit të tyre pa pëlqimin boshnjak;
19. *Ballkani Perëndimor*: Një tablo e re e krijuar me marrëdhënie armiqësore midis njerëzve në rajon që rezultojnë në dhunë sporadike dhe zhvendosje që kërcënojnë të gjithë rajonin.

Krijimi i një Kosove jofunkionale me një veri autonome do të çimentoj politikën e zgjidhjes së shpejtë të komunitetit ndërkombëtar në Ballkanin Perëndimor, dhe në vend të stabilizimit të rajonit ajo do të bëjë të kundërtën. Kjo do të kërkojë një tjetër përfshirje ndërkombëtare në rajon gjatë dekadës së ardhshme, për shkak të pasojave negative të shkurtpamësisë së politikës së vet.

Në planin afat-mesëm, kjo politikë do të rezultojë në krijimin e një terreni të përshtatshëm për rishikimin e plotë të kufijve të tanishëm në rajon. Shqiptarët, ashtu si qëndrojnë aktualisht, nuk janë të gatshëm për hapjen e këtij skenari; ekzistenca e Maqedonisë në tërësi do të rrezikohet duke përfshirë shtete të tjera përtej Ballkanit Perëndimor, ndërsa BeH ka të ngjarë që të shpërbëhet. Këto ndryshime në rajon nuk do të ndodhin në mënyrë paqësore.